



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada – Government  
Ministria e Zhvillimit Rajonal  
Ministarstvo za Regionalni Razvoj  
Ministry of Regional Development

# ANALIZË E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM SOCIO-EKONOMIK RAJONAL TË BALANCUAR NË KOSOVË PZHRB-2022



DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM DHE  
ANALIZA SOCIO-EKONOMIKE  
RAJONALE-DPASER

Korrik, 2023



Ky dokument është produkt i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, dhe i njejtë duhet të shërbejë për nevojat e vet këtij institucioni, Ministrive të linjës dhe bizneseve të sektorit privat të Republikës së Kosovës, lidhur me hartimin dhe zhvillimin e programeve në ndikim të mjedisit biznesor.

### **Dokumenti u hartua nga Grupi Punues:**

**Kryesuese:** Vjendita Avdiu Musliu - Udhëheqëse e Divizionit për Zhvillim Rajonal të Balancuar

**Anëtar:** Xhevat Sefaj – Zyrtar për zhvillim socio ekonomik

**Anëtare:** Blinda Bytyçi – Konsulente për zhvillim socio ekonomik

## PËRMBAJTJA:

I. Hyrje .....	4
II. Implementimi i programeve nga MZHR dhe Ministritë e Linjës për përkrahje të sektorit privat – bizneseve në Kosovë, në vitin 2022 .....	7
2.1 Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB (2022) implementuar nga MZHR (Ministria e Zhvillimit Rajonal) .....	8
III. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar, PZHRB 2022 .....	11
3.1 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Qendër .....	11
Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës .....	12
3.2 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Jug.....	19
Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës .....	20
3.3 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Perëndim.....	27
Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës .....	28
3.4 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Veri .....	35
Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës .....	36
3.5 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Lindje.....	43
Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës .....	44
IV. Paraqitja grafike dhe numerike e punësimit në kuadër të skemes të programit për mbështetjen e sektorit privat (PZHRB 2022).....	52
V. Shuma e përgjithshme e investimeve në vlerë dhe (%), përfshirë lotet (Lot1-Start up, Lot1-Biznes ekzistues), në pesë (5) Rajonet Zhvillimore në Kosovë.....	54
VI. Shpërndarja e projekteve të financuara nga Skema PZHRB (2022) sipas pesë (5) rajoneve zhvillimore .....	58
6.1 Shuma e përgjithshme e investimeve në (%) sipas sektorëve në kuadër të programit mbështetës “PZHRB – 2022”.....	60
6.2 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së projekteve sipas komuniteteve në rajone zhvillimore PZHRB (2022).....	61
VII. Projektet përfituese nga gratë për vitin 2022, programi “PZHRB” .....	63
7.1 Shpërndarja tabelare e projekteve përfituese të udhëhequra nga gratë sipas rajoneve zhvillimore dhe sipas Loteve ( Start Up, Lot1 dhe Lot 2), PZHRB 2022.....	64
VIII. Programi për përkrahjen e NMVM-ve 2022 nga MINT .....	68
X. Programi për Zhvillim Rural për vitin 2022 nga MBPZHR .....	71
XI. Shpërndarja e balancuar e investimeve për mbështetjen e sektorit privat nga Ministritë e Linjes.....	81
XII. Përfundime dhe rekomandime.....	83

## **LISTA E SHKURTESAVE:**

**MZHR** - Ministria e Zhvillimit Rajonal

**MBPZHR** - Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**MINT** - Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

**PZHRB** - Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar

**PZHR** - Programi për Zhvillim Rajonal

**AZHR** - Agjensioni për Zhvillim Rajonal

**RZHK** - Rajonet Zhvillimore të Kosovës

**RZHQ** - Rajoni Zhvillimor Qendër

**RZHL** - Rajoni Zhvillimor Lindje

**RZHJ** - Rajoni Zhvillimor Jug

**RZHV** - Rajoni Zhvillimor Veri

**RZHP** - Rajoni Zhvillimor Perëndim

## I. Hyrje

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) bazuar në mandatin e saj ligjor të përcaktuar me Shtojcën (15), të Rregullores (QR) Nr. 02/2021, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 04/2021 për fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Planin e Punës për vitin 2022, ka përgatitur dokumentin analitik “Analizë e Zhvillimit Socio-Ekonomik Rajonal të Balancuar në Kosovë” për vitin 2022, duke përfshirë “Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar” (PZHRB) të implementuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal gjatë vitit 2022. MZHR zhvillon, menaxhon dhe promovon programe për të ofruar zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Synimi i përgjithshëm i MZHR-së përmes reliazimit të programeve të thirrjeve është zhvillimi socio-ekonomik rajonal i balancuar përmes zhvillimit të ndërmarrësisë në pesë rajonet zhvillimore të Kosovës. Zvogëlimi i papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës me theks të veçantë për të rinjtë, përkrahja e zhvillimit të bizneseve të reja dhe atyre me potencial rritjeje si dhe përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve. Këto janë disa prej synimeve specifike që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik rajonal.

Në kuadër të mandatit të MZHR-së për përgatitjen e analizave lidhur me zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar kjo analizë trajton përkrahjen e MZHR-së dhe Ministrive tjera të Linjës ndaj sektorit privat (bizneseve) e realizuar për vitin 2022. Këtu trajtohen gjerësisht programet (skemat) për dhënien e granteve të implementuara edhe nga Ministrinë tjera të linjës. Çështjet kryesore që e përbëjnë “*Analizën për Zhvillimin Socio-Ekonomik Rajonal të Balancuar në Kosovë për vitin 2022*” janë:

- Numri i aplikimeve të bizneseve sipas rajoneve zhvillimore dhe komunave;
- Numri i përfituesve (bizneseve) sipas rajoneve zhvillimore dhe komunave;
- Vlera financiare e financimit për bizneset përfituese;
- Vlera e bashkëfinancimit nga bizneset përfituese;
- Sektorët përfitues më të financuar sipas rajoneve zhvillimore;
- Numri i vendeve të reja të punës të krijuara nga bizneset përfituese;
- Numri i vendese të reja të punës sipas gjinisë;
- Numri i përfituesëve sipas Loteve të mbështetura nga Programi (PZHRB);
- Numri i përfituesve sipas përkatësisë etnike sipas rajoneve zhvillimore;
- Numri i përfituesve sipas gjinisë sipas rajoneve zhvillimore;

- Komunat që kanë përfituar më së shumti projekte sipas rajoneve zhvillimore dhe komunat që nuk kanë qenë përfituese.

Përmes publikimit të kësaj analize, MZHR synon të vë në pah ndikimin e saj në zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar përmes financimit të projekteve në pesë (5) rajoneve zhvillimore si: rajonin Qendër, Veri, Jug, Lindje dhe Perëndim. Analiza pasqyron subvencionimin e bizneseve duke paraqitur zgjerimin e kapaciteteve të tyre pas implementimit të projekteve të tyre përfituese si: rritjen e qarkullimit, shtimin e kapaciteteve prodhuese dhe resurseve njerëzore, etj.

Gjatë vitit 2022, Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), ka implementuar “Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB 2022” i cili është realizuar përmes Skemës së Granteve për mbështetje financiare ndaj bizneseve. Përmes kësaj Skeme MZHR mbështet bizneset mikro dhe të vogla, ndihmon bizneset në plotësimin e nevojave të tyre për të bërë biznes, zgjerimin e kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese. MZHR përmes partnerëve ndërkombëtar si (BERZH, UNICEF, GIZ, USAID, CARITAS etj), ka arritur të ndihmojë bizneset të zgjerojnë kapacitetet e tyre prodhuese duke arritur një qëndrueshmëri afatgjatë të funksionimit. Gjithashtu MZHR bashkë me partnerët e saj ka realizuar trajnime profesionale në ngritjen e kapaciteteve të tyre humane, menaxhuese ,menaxhim financiar etj.

Ministria e Zhvillimit Rajonal mban rregullisht sesione informuese për aplikantët potencial/bizneset për formën e aplikimit online në sistemin elektronik E-Kosova si dhe sesione informuese për implementimin e projekteve. Sesionet informuese realizohen rregullisht në bashkëpunim me AZHR-të në pesë (5) rajonet zhvillimore në të cilat operon MZHR. Skema e Granteve PZHRB (2022) inkurajon aplikime me projekte inovative nga gratë dhe të rinjtë dhe komunitetet jo shumicë të aplikojnë në kuadër të kësaj skeme.


Bazuar në analizën tre (3) vjeçare (2018-2020) dhe analizat vjetore për vitet 2021 dhe 2022, MZHR përmes PZHRB-së prej periudhës 2018-2022 ka investuar vleren prej **11,038,302.01€**, ka gjeneruar rreth **3384** vende të reja pune dhe ka investuar një numër prej **1159** projektsh.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar fuqizimit të bizneseve në sektorin e prodhimit si faktor kyç i zhvillimit ekonomik duke mundësuar hapjen e vendeve të reja të punës dhe duke ndikuar kështu në uljen e papunësisë.

Tabela 1: Paraqitja tabelare e punësimit, projektet dhe vlerat e financimit PZHRB, MASA 8 dhe MASA 15 prej periudhes 2018-2022

Vitet	Vlera e financimit	Nr.i të punësuarve	Nr. i projekteve
PZHRB (2018)	1,346,806.00	439	145
PZHRB (2019)	2,387,69.45	751	201
PZHRB (2020) MASA 8	2,896,513.85	958	317
PZHRB (2021) MASA 15	1,376,278.62	365	164
PZHRB (2022)	3,030,934.09	871	332
<b>TOTAL</b>	<b>11,038,302.01</b>	<b>3384</b>	<b>1159</b>

Grafikoni 1: Paraqitja përmbledhëse PZHRB, MASA 8 dhe MASA 15 prej periudhës 2018-2022



## II. Implementimi i Programeve nga MZHR dhe Ministritë e Linjës për përkrahje të sektorit privat – bizneseve në Kosovë, në vitin 2022

Roli dhe fuqizimi i sektorit privat si promotor i zhvillimit ekonomik është shumë i rëndësishëm për ekonominë e tregut siç është rritja e produktivitetit, ruajtja e konkurrencës dhe sjellja e vlerës së shtuar në vendin tonë. Duke u bazuar në mandatin ligjor dhe buxhetin e aprovuar me ligjin vjetor të buxhetit, disa prej ministrive të Qeverisë së Republikës së Kosovës zhvillojnë dhe realizojnë programe në përkrahje sektorit privat duke financuar kështu implementimin projekteve të këtyre bizneseve.

Viti 2022 është viti i pestë me radhë që Ministria e Zhvillimit Rajonal implementon programin për përkrahje të bizneseve, “Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB)”. Ministria e Zhvillimit Rajonal është përcaktuar përgjegjëse për zbatimin dhe për mbështetjen e programeve ekzistuese që lidhen me zhvillimin rajonal e që ndikojnë në zhvillimin rajonal të balancuar. MZHR përveç përkrahjes së bizneseve në sektorin e prodhimit, gjithashtu ka përkrahur edhe sektorin e shërbimeve duke përfshirë dhe TI-në konform buxhetit të aprovuar dhe të paraparë për realizimin e këtyre programeve.

Duke u bazuar në ngjashmërinë e programeve lidhur me kualifikueshmërinë e llojeve të bizneseve (mikro, të vogla dhe të mesme) dhe sektorëve (prodhim dhe shërbim) në të cilët janë përkrahur bizneset nga ministritë e linjës në vitin 2022, MZHR në vitin 2022 në këtë analizë ka shtjelluar edhe thirrjet për mbështetje të bizneseve të financuara nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Më poshtë janë shtjelluar qëllimet e këtyre thirrjeve. Ndërkaq programet e implementuara nga MZHR i gjeni të shtjelluara dhe të detajuara në pesë (5) rajone zhvillimore. **Në këtë analizë trajtohen këto programe të realizuara për përkrahjen e bizneseve për v.2022 sipas pesë rajoneve zhvillimore:**

1. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2022) realizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR);
2. Programi për përkrahjen e NMVM-ve, i realizuar nga KIESA/MINT, programi për përkrahjen e bizneseve fillestare i realizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë MINT;
3. Programi për subvencionim nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
4. Departamenti i Inovacionit/MINT



Zgjerimi i kapaciteteve biznesore, gjenerimi i vendeve të reja të punës dhe rritja e eksportit zëvendësimi i importit, janë synimet kryesore të tre (3) programeve. Mbi bazën e kapaciteteve profesionale në dispozicion, funksionimit të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndër-institucional, MZHR do të vazhdojë përpjekjet që të përfshijë edhe programe tjera në analizat e viteve vijuese.

## **2.1 Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB (2022) implementuar nga MZHR (Ministria e Zhvillimit Rajonal)**

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2022 është realizuar përmes publikimit dhe realizimit të Skemës së Granteve për biznese e shpërndarë në tre (3) lote. Synim kryesor i kësaj skeme është që të mbështesë dhe mundësojë sa më shumë projekte cilësore afariste të implementohen dhe zhvillohen në rritjen e kapaciteteve të tyre në të gjitha segmentet, krijimin e vendeve të reja të punës si dhe mbështetjen e nën sektorëve në kuadër të sektorit egzistues. Kjo thirrje poashtu ka për synim edhe ndikimin e saj në një zhvillim socio ekonomik të balancuar sipas rajoneve zhvillimore duke mbështetur bizneset e reja dhe ato me potencial në rritje, mbështet rritjen e importit dhe zvoglimin e eksportit dhe zvoglimin e papunisë. MZHR përmes Udhëzuesit për aplikant për grante parasheh gjitha udhëzimet, rregullat dhe procedurat tjera të aplikimit përmes sistemit E-Kosova. Sipas raporteve përmbledhëse nga Departamenti për Zhvillim Rajonal (DZHR) për implementimin e këtyre programeve nga MZHR në të gjitha rajonet zhvillimore nga programi PZHRB-2022 janë përkrahur **(332)** projekte dhe janë krijuar kushte për **(871)** vende të reja të punës. Gjithsej vlera totale financiare e projekteve të implementuara për **“PZHRB-2022”** është **3,030,934.09 €** ku në kategorinë Start Up janë financuar **185** projekte në vlerën **857,715.11 €**, në kategorinë Lot1 janë financuar **60** projekte në vlerë **525,340.06 €** dhe Lot 2 janë financuar **87** projekte në vlerën **1,647,878.92 €**. Në kuadër të Skemes së Granteve PZHRB (2022) janë pranuar **1549** aplikime nga pesë (5) rajonet zhvillimore ku, **835** aplikime janë pranuar në total nga pesë rajonet zhvillimore në **StartUp** kategorinë, **317** aplikime në kategorinë **Lot 1** dhe **397** aplikime në kategorinë **Lot 2**. Përkufizimi i lotëve sipas PZHRB (2022) dhe mjetet e dedikuara për secilin lot, kanë qenë si vijon:

- Lot 1 – Start up - ndërmarrje të reja/ fillestare);  
**Shuma e granteve: 2,000.00 € deri në 5,000.00 €;**
- Lot 1 – Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla  
**Shuma e granteve: 5,000.01 € deri në 10,000.00 €;**
- Lot 2 – Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla  
**Shuma e granteve: 10,000.01 € deri në 20,000.00 €;**

Skema e Granteve bazuar në “Programin Zhvillimor Rajonal të Balancuar” gjatë vitit 2022, ka mbështetur gjithsej (332) projekte të cilat janë shpërndarë si më poshtë në pesë (5) rajone zhvillimore ( Qendër, Lindje, Perëndim, Veri dhe Jug):

- Në rajonin socio-ekonomik *Qendër* (Komuna e Prishtinës me komunat përreth), janë përkrahur gjashtëmbëdhjetë (**79**) projekte;
- Në rajonin socio-ekonomik *Lindje* (Komuna e Gjilanit me komunat përreth), janë përkrahur tetëmbëdhjetë (**73**) projekte;
- Në rajonin socio-ekonomik *Perëndim* (Komuna e Pejës me komunat përreth), janë përkrahur tetëmbëdhjetë (**61**) projekte;
- Në rajonin socio-ekonomik *Veri* (Komuna e Mitrovicës Jugore me komunat përreth), janë përkrahur gjashtëmbëdhjetë (**46**) projekte;
- Në rajonin socio-ekonomik *Jug* (Komuna e Prizrenit me komunat përreth, gjashtëmbëdhjetë (**73**) projekte.

Në kuadër të Skemës (*PZHRB - 2022*), MZHR ka pranuar gjithsej **1549** aplikacione në pesë (5) rajonet zhvillimore të ndara me lotet si vijon:

- Në Lot1 (*Start up*) janë pranuar **835** aplikacione;
- Në Lot1 (*Biznese ekzistuese*) janë pranuar **317** aplikacione;
- Lot 2 – *Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla* janë pranuar **397** aplikacione.

Në kuadër të Skemës (*PZHRB - 2022*), MZHR ka financuar sipas Loteve gjithsej **332** projekte në pesë (5) rajonet zhvillimore të ndara me lotet si vijon:

- Në Lot1 (*Start up*) janë financuar **185** projekte;
- Në Lot1 (*Biznese ekzistuese*) janë financuar **60** projekte;
- Lot 2 – *Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla* janë financuar **87** projekte.

Sa i përket numrit të përgjithshëm të personave të punësuar në (5) pesë rajonet zhvillimore të Kosovës në kuadër të PZHRB (2022) për tre Lotet (L1- Start up, Lot1- Biznese ekzistues dhe Lot 2), në vitin 2022 janë **871** të punësuar të rinjë<sup>1</sup>, ku nga ata në:

- *Rajonin Zhvillimor Qendër* – **226** të punësuar të rinjë;
- *Rajonin Zhvillimor Lindje* – **166** të punësuar të rinjë;
- *Rajonin Zhvillimor Perëndim* – **155** të punësuar të rinjë;

---

<sup>1</sup> ATK (lista e të punësuarve për vitin 2022)

- *Rajonin Zhvillimor Veri* – **133** të punësuar të rinjë;
- *Rajonin Zhvillimor Jug* – **191** të punësuar të rinjë.

Referuar edhe analizës tre (3) vjeçare 2018 – 2020 si dhe analizës vjetore për v.2021 të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe deri në këtë vit 2022 shohim që kërkesa për aplikim Lotin (Start Up) biznese në themelim është gjithnjë e në rritje program ky që kryesisht përfaqësohet nga kërkesat prej moshave të reja.

Llojet e veprimtarive të projekteve të mbështetura nga Grant Skema për **“Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2022”**, përfshinë sektorët e prodhimit dhe shërbimit si:  
**Prodhim:** Industria e përpunimit të ushqimit - Sektori i miellit dhe produkteve të furrës; Sektori i përpunimit të qumështit dhe produkteve nga qumështi; Industria e përpunimit të metalit; Industria e tekstit dhe lëkurës; Industria e përpunimit të drurit - sektori i zdrukthtarisë dhe artikujve tjerë nga druri; Sektori I prodhimit të letrës dhe produkteve prej letrës; Industria e plastikës dhe gomës; etj.

**Shërbime:** Teknologji informative (Softwer, Hardwer); Gastronomi; Shërbime në fushën e inxhinierisë dhe këshillimit teknik; Ambalazhim i produkteve; Shërbime të parukerisë; Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve; Shërbime financiare; Media, kulturë (krijim filmash), grafik, marketing; Dizajn mode dhe rrobaqepësi; Edukim (pajisje për qendra edukative, çerdhe); Konsulencë (të ndryshme); Tekstil; Operatorë turistikë; Instalimi i makinerive industriale; Shërbime elektrike, hidrosanitare; etj.

Në vitin 2022 është përjashtuar sektori i bujqësisë (për pajisjet që financohen nga MBPZHR), ndërtimit, shëndetësisë dhe tregtisë.

Në tabelat e mëposhtme në vijim të dokumentit do të mund të shihni në formë të detajizuar të gjitha projektet e financuara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal për vitin 2022. Programet janë të paraqitura në pesë rajonet socio-ekonomike në Kosovë, të ndara përmes loteve: Lot1 (Start Up), Lot1 (biznese ekzistuese) dhe Lot2 (biznese ekzistuese). Këtu do të analizojmë dhe pasqyrojmë shpërndarjen e balancuar të financimit të projekteve nëpër rajone dhe komuna, si dhe do të vërejmë ndikimin që kanë pasur këto programe zhvillimore në zhvillimin rajonal të balancuar në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Vlera e financimit e investuar nga MZHR është gjithsej **(3,030,934.09)€** për pesë (5) rajonet socio-ekonomike zhvillimore. Ndërsa gjithsej vlera bashkëfinancimit për vitin 2022, nga bizneset përfituese për pesë (5) rajonet zhvillimore është **(725,791.76) €**.

### III. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar, PZHRB 2022

#### Përkrahja e sektorit privat

##### 3.1 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Qendër

Rajoni Zhvillimor Qendër përfshinë tetë (8) Komuna: (Prishtinë, Drenas, Fushë Kosovë, Graçanicë, Shtime, Podujevë Obiliq dhe Lipjan).

Nga Programi për Zhvillim Rajonal në Rajonin Zhvillimor Qendër, janë përkrahur:

- **79 (shtatëdhjetë e nëntë) biznese në vlerë prej 711,789.69€;**

Në kuadër të Skemës (PZHRB - 2022) MZHR ka financuar në RZHQ sipas Loteve gjithsej projekte në pesë (5) rajonet zhvillimore të ndara me lotet si vijon:

- *Në Lot1 (Start up) janë financuar 43 projekte;*
- *Në Lot1 (Biznese ekzistuese) janë financuar 18 projekte;*
- *Lot 2 – Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla janë financuar 18 projekte.*

Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar - PZHRB (2022) në rajonin zhvillimor Qendër janë pranuar 406 aplikacione në tre (3) Lotet (Start Up, Lot1 dhe Lot2) nga tetë komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikacioneve prej **406** në kategorinë:

- *Në Lot 1 - (Start up) janë pranuar 219 aplikacione;*
- *Në Lot 2 - (Biznese ekzistuese) janë pranuar 87 aplikacione.*
- *Lot 2 – Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla janë pranuar 102 aplikacione;*

Shuma dhe numri i projekteve të financuara nëpër Lote sipas PZHRB (2022) është si vijon:

- Loti 1 (Start Up) – Projekte të reja biznesi:  
Shuma e granteve: nga 2,000.00 € deri në 5,000.00 €;
  - Katëdhjetë e tre (43) projekte në vlerë **200,323.10€;**
- Loti 1 (Ndërmarrjet ekzistuese):  
Shuma e granteve: nga 5,000.01 € deri në 10,000.00 €;
  - Tetëmbëdhjetë (18) projekte në vlerë **164,814.99€.**
- Lot 2 – Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla  
Shuma e granteve: 10,000.01 € deri në 20,000.00 €;
  - Tetëmbëdhjetë (18) projekte në vlerë **346,651.60€.**

Vlerat e bashkëfinancimit nga bizneset përfituese (PZHRB 2022) në RZHQ:

- *Kategoria Lot1 (Start up) është bashkëfinancuar në vlerë 51,770.66€;*
- *Kategoria Lot1 (Biznese ekzistuese) është bashkëfinancuar në vlerë 44,557.59€;*
- *Kategoria Lot 2 Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla është bashkëfinancuar në vlerë 99,053.40€ ;*

**Totali i bashkëfinancimit për tre (3) lotet në Rajonin Zhvillimor Qendër është 195,381.65€.**

### **Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës**

Sipas Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2022), në rajonin zhvillimor Qendër sektori më i financuar janë shërbimet me një numër të projekteve prej pesëdhjetë e katër **(54)**, duke vijuar me sektorin e prodhimit me një numër prej njëzet e pesë **(25)** projekteve.

Punësimi në tre Lotet në RZHQ sipas PZHRB (2022) është si vijon:

- *Në Lot1 (Start up) janë njëqindekatër **(107)** të punësuar;*
- *Në Lot1 (Biznese ekzistuese) janë pesëdhjetëepesë **(55)** të punësuar;*
- *Lot 2 – Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla janë gjashtëdhjetëekatër **(64)** të punësuar.*

Gjithsej në kuadër të PZHRB (2022) janë **226** të punësuar duke përfshirë (Start Up, Lot1 dhe Lot 2) në të gjitha komunat përbërëse të këtij rajon.

Tabela 2. Paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHQ (Start Up, PZHRB- 2022)

RAJONI SOCIO-EKONOMIK QENDËR (START UP - PZHRB 2022)																																																																																															
Start Up	Komuna përfituese	Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2022)	Numri I bizneseve përfituese (2022)	Sektorët përfitues	Nr. I projekteve sipas sektorëve	Numri I të punësuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Totali i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2022)																																																																																						
	Prishtinë	135	26	Prodhim	4	67	123,442.10	39824.92	163,267.02 €																																																																																						
				Shërbime	22						Drenas	12	2	Prodhim	0	5	9,890.00 €	1,182.50 €	11,072.50 €	Shërbime	2		Fushë Kosovë	22	3	Prodhim	0	4	12,057.00 €	1,490.00 €	13,547.00 €	Shërbime	3		Graçanicë	4	1	Prodhim	1	5	4,272.00 €	528.00 €	4,800.00 €	Shërbime	0		Lipjan	11	2	Prodhim	1	6	9,200.00 €	1,405.00 €	10,605.00 €	Shërbime	1		Obiliq	3	1	Prodhim	0	2	5,000.00 €	2,300.00 €	7,300.00 €	Shërbime	1		Podujevë	21	5	Prodhim	0	12	22,672.00 €	3,060.24 €	25,732.24 €	Shërbime	5		Shtime	11	3	Prodhim	1	6	13,790.00 €	1,980.00 €	15,770.00 €	Shërbime	2	Gjithsej: (Start Up)	/
	Drenas	12	2	Prodhim	0	5	9,890.00 €	1,182.50 €	11,072.50 €																																																																																						
				Shërbime	2						Fushë Kosovë	22	3	Prodhim	0	4	12,057.00 €	1,490.00 €	13,547.00 €	Shërbime	3		Graçanicë	4	1	Prodhim	1	5	4,272.00 €	528.00 €	4,800.00 €	Shërbime	0		Lipjan	11	2	Prodhim	1	6	9,200.00 €	1,405.00 €	10,605.00 €	Shërbime	1		Obiliq	3	1	Prodhim	0	2	5,000.00 €	2,300.00 €	7,300.00 €	Shërbime	1		Podujevë	21	5	Prodhim	0	12	22,672.00 €	3,060.24 €	25,732.24 €	Shërbime	5		Shtime	11	3	Prodhim	1	6	13,790.00 €	1,980.00 €	15,770.00 €	Shërbime	2	Gjithsej: (Start Up)	/	<b>219</b>	<b>43</b>	/	<b>43</b>	<b>107</b>	<b>200,323.10</b>	<b>51,770.66</b>	<b>252,093.76</b>				
	Fushë Kosovë	22	3	Prodhim	0	4	12,057.00 €	1,490.00 €	13,547.00 €																																																																																						
				Shërbime	3						Graçanicë	4	1	Prodhim	1	5	4,272.00 €	528.00 €	4,800.00 €	Shërbime	0		Lipjan	11	2	Prodhim	1	6	9,200.00 €	1,405.00 €	10,605.00 €	Shërbime	1		Obiliq	3	1	Prodhim	0	2	5,000.00 €	2,300.00 €	7,300.00 €	Shërbime	1		Podujevë	21	5	Prodhim	0	12	22,672.00 €	3,060.24 €	25,732.24 €	Shërbime	5		Shtime	11	3	Prodhim	1	6	13,790.00 €	1,980.00 €	15,770.00 €	Shërbime	2	Gjithsej: (Start Up)	/	<b>219</b>	<b>43</b>	/	<b>43</b>	<b>107</b>	<b>200,323.10</b>	<b>51,770.66</b>	<b>252,093.76</b>																
	Graçanicë	4	1	Prodhim	1	5	4,272.00 €	528.00 €	4,800.00 €																																																																																						
				Shërbime	0						Lipjan	11	2	Prodhim	1	6	9,200.00 €	1,405.00 €	10,605.00 €	Shërbime	1		Obiliq	3	1	Prodhim	0	2	5,000.00 €	2,300.00 €	7,300.00 €	Shërbime	1		Podujevë	21	5	Prodhim	0	12	22,672.00 €	3,060.24 €	25,732.24 €	Shërbime	5		Shtime	11	3	Prodhim	1	6	13,790.00 €	1,980.00 €	15,770.00 €	Shërbime	2	Gjithsej: (Start Up)	/	<b>219</b>	<b>43</b>	/	<b>43</b>	<b>107</b>	<b>200,323.10</b>	<b>51,770.66</b>	<b>252,093.76</b>																												
	Lipjan	11	2	Prodhim	1	6	9,200.00 €	1,405.00 €	10,605.00 €																																																																																						
				Shërbime	1						Obiliq	3	1	Prodhim	0	2	5,000.00 €	2,300.00 €	7,300.00 €	Shërbime	1		Podujevë	21	5	Prodhim	0	12	22,672.00 €	3,060.24 €	25,732.24 €	Shërbime	5		Shtime	11	3	Prodhim	1	6	13,790.00 €	1,980.00 €	15,770.00 €	Shërbime	2	Gjithsej: (Start Up)	/	<b>219</b>	<b>43</b>	/	<b>43</b>	<b>107</b>	<b>200,323.10</b>	<b>51,770.66</b>	<b>252,093.76</b>																																								
	Obiliq	3	1	Prodhim	0	2	5,000.00 €	2,300.00 €	7,300.00 €																																																																																						
				Shërbime	1						Podujevë	21	5	Prodhim	0	12	22,672.00 €	3,060.24 €	25,732.24 €	Shërbime	5		Shtime	11	3	Prodhim	1	6	13,790.00 €	1,980.00 €	15,770.00 €	Shërbime	2	Gjithsej: (Start Up)	/	<b>219</b>	<b>43</b>	/	<b>43</b>	<b>107</b>	<b>200,323.10</b>	<b>51,770.66</b>	<b>252,093.76</b>																																																				
	Podujevë	21	5	Prodhim	0	12	22,672.00 €	3,060.24 €	25,732.24 €																																																																																						
				Shërbime	5						Shtime	11	3	Prodhim	1	6	13,790.00 €	1,980.00 €	15,770.00 €	Shërbime	2	Gjithsej: (Start Up)	/	<b>219</b>	<b>43</b>	/	<b>43</b>	<b>107</b>	<b>200,323.10</b>	<b>51,770.66</b>	<b>252,093.76</b>																																																																
	Shtime	11	3	Prodhim	1	6	13,790.00 €	1,980.00 €	15,770.00 €																																																																																						
				Shërbime	2					Gjithsej: (Start Up)	/	<b>219</b>	<b>43</b>	/	<b>43</b>	<b>107</b>	<b>200,323.10</b>	<b>51,770.66</b>	<b>252,093.76</b>																																																																												
Gjithsej: (Start Up)	/	<b>219</b>	<b>43</b>	/	<b>43</b>	<b>107</b>	<b>200,323.10</b>	<b>51,770.66</b>	<b>252,093.76</b>																																																																																						

Tabela 3. Paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHQ ( Lot1, PZHRB, 2022)

<b>RAJONI SOCIO-EKONOMIK QENDËR (LOT1 - PZHRB 2022)</b>										
<b>LOT 1</b>	<b>Komuna përfituese</b>	<b>Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2022)</b>	<b>Numri I bizneseve përfituese (2022)</b>	<b>Sektorët përfitues</b>	<b>Nr. I projekteve sipas sektorëve</b>	<b>Numri I të punësuarve</b>	<b>Vlera e financuar nga MZHR (€)</b>	<b>Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset</b>	<b>Tot i financimit dhe bashkëfinancimit (2022)</b>	
	Prishtinë	48	12	Prodhim	1	38	107,674.45 €	23,288.13 €	130,962.58 €	
				Shërbime	11					
	Drenas	1	1	Prodhim	0	3	9,740.54	6,069.46	15,810.00	
				Shërbime	1					
	Fushë Kosovë	7	2	Prodhim	0	4	20,000.00	3,200.00	23,200	
				Shërbime	2					
	Graçanicë	1	0	Prodhim	0	0	0	0	0	
				Shërbime	0					
	Lipjan	7	1	Prodhim	1	4	9,000	3,600.00	12,600	
				Shërbime	0					
	Obiliq	1	0	Prodhim	0	0	0	0	0	
				Shërbime	0					
	Podujevë	11	1	Prodhim	0	3	8,500.00	4,800.00	13,300.00	
				Shërbime	1					
	Shtime	11	1	Prodhim	0	3	9,900.00	3,600.00	13,500.00	
				Shërbime	1					
	<b>Gjithsej: (Lot 1)</b>	<b>/</b>	<b>87</b>	<b>18</b>	<b>/</b>	<b>18</b>	<b>55</b>	<b>164,814.99</b>	<b>44,557.59</b>	<b>209,372.58</b>

Tabela 4. Paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHQ ( Lot2, PZHRB, 2022)

RAJONI SOCIO-EKONOMIK QENDËR (LOT2 - PZHRB 2022)									
LOT 2	Komuna përfituese	Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2022)	Numri I bizneseve përfituese (2022)	Sektorët përfitues	Nr. I projekteve sipas sektorëve	Numri I të punësuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2022)
Prishtinë		74	10	Prodhim	8	40	199,301.60 €	46,583.40 €	243,885.00 €
				Shërbime	2				
Drenas		1	1	Prodhim	1	3	17,000.00	8,220.00	25,220.00
				Shërbime	0				
Fushë Kosovë		4	1	Prodhim	1	2	20,000.00	3,600.00	23,600.00
				Shërbime	0				
Graçanicë		1	2	Prodhim	2	7	39,000.00	20,500.00	59,500.00
				Shërbime	0				
Lipjan		3	1	Prodhim	1	1	16,000.00	2,500.00	18,500.00
				Shërbime	0				
Obiliq		1	0	Prodhim	0	0	0	0	0
				Shërbime	0				
Podujevë		9	2	Prodhim	2	9	39,350.00	15,150.00	54,500.00
				Shërbime	0				
Shtime		9	1	Prodhim	1	2	16,000.00	2,500.00	18,500.00
				Shërbime	0				
<b>Gjithsej: (Lot 2)</b>	<b>/</b>	<b>102</b>	<b>18</b>	<b>/</b>	<b>18</b>	<b>64</b>	<b>346,651.60</b>	<b>99,053.40</b>	<b>443,705.00</b>



Tabela 5. Paraqitja e përgjithshme e investimeve për rajonin zhvillimor QendërPZHRB 2022, Lotet (Start Up, Lot1dhe Lot2).

RAJONI SOCIO-EKONOMIK QENDËR	Start Up, Lot 1, Lot 2	Nr. i përgjithëshëm i aplikimeve (2022)	Numri I bizneseve përfituese (2022)	Numri I të punësuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2022)
	Start Up	219	43	107	200,323.10 €	51,770.66 €	252,093.76 €
	LOT 1	87	18	55	164,814.99 €	44,557.59 €	209,372.58 €
	LOT 2	102	18	64	346,651.60 €	99,053.40 €	445,705.00 €
	<b>Gjithsej:</b>	<b>408</b>	<b>79</b>	<b>226</b>	<b>711,789.69 €</b>	<b>195,381.65 €</b>	<b>907,171.34 €</b>

Tabela 6. Parqitja tabelare e sektorëve të mbështetur nga PZHRB 2022, në RZHQ

RAJONI SOCIO-EKONOMIK QENDËR	Start Up		LOT 1		Lot 2	
	Prodhim	Shërbim	Prodhim	Shërbim	Prodhim	Shërbim
	7	36	2	16	16	2
<b>Gjithsej</b>	<b>43</b>		<b>18</b>		<b>18</b>	

**PZHRB (2022)** ka realizuar gjithsej shumën e investime në rajonin zhvillimor Qendër në vlerën prej **711,789.69€**, me një numër të përgjithshëm prej shtatëdhjetë e nëntë **79** projekte, nga gjithsej **408** numër të aplikuesëve. Në këtë rajon numri më i madh i aplikuesve është pranuar në Lotin (Start Up), me një numër prej **219** të aplikuesëve **43** përfitues, ndërsa në Lot 1, **87** aplikues apo **18** përfitues dhe Lot 2, **102** aplikues apo **18** përfitues në kuadër të Skemës së PZHRB-së për vitin 2022. Ndërkaq numri më i vogël i aplikimeve është pranuar në Lot 1 (biznes ekzistues), me gjithsej **(86)** aplikues. Shuma totale e bashkëfinancimit në Rajonin Zhvillimor Qendër është **195,381.65€** që nënkupton që në RZHQ së bashku me vlerën e financimit prej **711,789.69€** janë mbështetur projekte në vlerë të përgjithshme prej **907,171.34€**.


Theksojmë që nga numri i përgjithshëm prej **79** projektesh që janë mbështet në RZHQ, pesëdhjetë e katër **(54)** projekte kanë pasur për veprimtari shërbimet, ndërsa njëzet e pesë **(25)** projekte veprimtarinë e prodhimit.

Në Rajonin Zhvillimor Qendër janë punësuar në total **226** persona, ku numri më i madh i të punësuarve është realizuar në kuadër të lotit (Start up) të bizneseve në themelim.


**Komunat në të cilat më së shumti është mbështetur sektori privat/bizneset në tre (3) Lote ( Start up, Lot1 dhe Lot2) / janë si mëposhtë:**

- Komuna Prishtinë , **(48)** projekte përfituese, **(257)** aplikime të pranuar;
- Komuna Podujevë, **(8)** projekte përfituese, **(41)** aplikime të pranuar;
- Komuna Fushë Kosovë, **(6)** projekte përfituese **(33)** aplikime të pranuar nga dy komunat.

Grafikoni 2: Paraqitja e tre komunave që kanë përfituar më së shumti në kuadër të Skemës PZHRB-2022, Rajoni Qendër



Grafikoni 3: Shpërndarja e Skemës së Granteve PZHRB-2022, Rajoni Qendër



### 3.2 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Jug

Rajoni Zhvillimor Jug, përshinë gjashtë (6) komuna të Republikës së Kosovës: (Rahovec, Malishevë, Prizren, Suharekë, Dragash dhe Mamushë).

Nga Programi për Zhvillim Rajonal në Rajonin Zhvillimor Jug, janë përkrahur:

- **73** (shtatëdhjetë e tre) biznese në vlerë prej **645,775.70€**;

Në kuadër të Skemës (PZHRB - 2022) MZHR ka financuar në RZHQ sipas Loteve gjithsej projekte në pesë (5) rajonet zhvillimore të ndara me lotet si vijon:

- Në Lot1 (Start up) janë financuar **40** projekte;
- Në Lot1 (Biznese ekzistuese) janë financuar **14** projekte;
- Në Lot 2 – Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla janë financuar **19** projekte.

Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar - PZHRB (2022) në rajonin zhvillimor Jug janë pranuar 406 aplikacione në tre (3) Lotet (Start Up, Lot1 dhe Lot2) nga gjashtë komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikacioneve prej **380** në kategorinë:

- Në Lot 1 - (Start up) janë pranuar **216** aplikacione;
- Në Lot 2 - (Biznese ekzistuese) janë pranuar **78** aplikacione.
- Lot 2 – Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla janë pranuar **86** aplikacione.

Shuma dhe numri i projekteve të financuara nëpër Lote në RZHJ sipas PZHRB (2022) është si vijon:

- Loti 1 (Start Up) – Projekte të reja biznesi:  
Shuma e granteve: nga 2,000.00 € deri në 5,000.00 €;
  - Katërbëdhjetë (**40**) projekte në vlerë **187,246.20**;
- Loti 1 (Ndërmarrjet ekzistuese):  
Shuma e granteve: nga 5,000.01 € deri në 10,000.00 €;
  - Trembëdhjetë (**14**) projekte në vlerë **112,504.50€**.
- Lot 2 – Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla  
Shuma e granteve: 10,000.01 € deri në 20,000.00 €;
  - Nëntëmbëdhjetë (**19**) projekte në vlerë **346,025.00€**.

Vlerat e bashkëfinancimit nga bizneset përfituese (PZHRB 2022) në RZHJ:

- *Kategoria Lot1 (Start up) është bashkëfinancuar në vlerë 35,152.53€;*
- *Kategoria Lot1 (Biznese ekzistuese) është bashkëfinancuar në vlerë 21,319.00€;*
- *Kategoria Lot 2 Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla është bashkëfinancuar në vlerë 104,943.00€ ;*

**Totali i bashkëfinancimit për tre lotet në Rajonin Zhvillimor Jug është 161,414.53 €**

### **Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës**

Sipas Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2022), në rajonin zhvillimor Jug, sektori më i financuar është sektori i shërbimit me një numër të projekteve prej katërdhjetë **40**, duke vijuar me prodhimin ku janë financuar gjithsej tridhjetetë **33** projekte përfituese.

Punësimi nëpër Lote në RZHJ sipas PZHRB (2022) është si vijon:

- *Në Lot1 (Start up) janë nëntëdhjetë e pesë (95) të punësuar;*
- *Në Lot1 (Biznese ekzistuese) janë tredhjetë e tre (33) të punësuar;*
- *Në Lot 2 – Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla janë gjashtëdhjetë e tre (63) të punësuar.*

Gjithsej në kuadër të PZHRB (2022) janë **191** të punësuar duke përfshirë (Start Up, Lot1 dhe Lot 2) në të gjitha komunat përbërëse të këtij ra

Tabela 7. Paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHJ (PZHRB, Start Up, 2022)

<b>RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG (START UP-PZHRB 2022)</b>									
<b>Start Up</b>	<b>Komuna përfitues e</b>	<b>Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2022)</b>	<b>Numri I bizneseve përfitues e (2022)</b>	<b>Sektorët përfitues</b>	<b>Nr. I projekteve sipas sektorëve</b>	<b>Numri i të punësuarve</b>	<b>Vlera e financuar nga MZHR (€)</b>	<b>Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset</b>	<b>Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2022)</b>
	Prizren	123	32	Prodhim	11	78	148,850.20 €	24,118.73 €	172,968.93 €
				Shërbime	21				
	Dragash	49	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0				
	Malishevë	5	1	Prodhim	0	2	4,266.00 €	474.00 €	4,740.00 €
				Shërbime	1				
	Mamushë	3	1	Prodhim	0	1	4,950.00 €	639.80 €	5,589.80 €
				Shërbime	1				
	Rahovec	16	3	Prodhim	1	6	14,980.00 €	6,420.00 €	21,400.00 €
				Shërbime	2				
	Suharekë	20	3	Prodhim	0	8	14,200.00 €	3,500.00 €	17,700.00 €
				Shërbime	3				
<b>Gjithsej: (Start Up)</b>		<b>216</b>	<b>40</b>	<b>/</b>	<b>40</b>	<b>95</b>	<b>187,246.20 €</b>	<b>35,152.53 €</b>	<b>222,398.73 €</b>

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Tabela 8. Paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHJ (Lot1, PZHRB, 2022)

RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG (LOT 1 - PZHRB 2022)										
LOT 1	Komuna përfituese	Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2022)	Numri I bizneseve përfituese (2022)	Sektorët përfitues	Nr. I projekteve sipas sektorëve	Numri I të punsuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2022)	
	Prizren	54	11	Prodhim	3	27	85,604.50 €	16,169.00 €	101,773.50 €	
				Shërbime	8					
	Dragash	3	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
				Shërbime	0					
	Malishevë	4	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
				Shërbime	0					
	Mamushë	2	1	Prodhim	0	2	10,000.00 €	2,950.00 €	12,950.00 €	
				Shërbime	1					
	Rahovec	11	1	Prodhim	1	2	7,000.00 €	1,000.00 €	8,000.00 €	
				Shërbime	0					
	Suharekë	4	1	Prodhim	0	2	9,900.00 €	1,200.00 €	11,100.00 €	
				Shërbime	1					
	<b>Gjithsej: (LOT 1)</b>		<b>78</b>	<b>14</b>		<b>14</b>	<b>33</b>	<b>112,504.50</b>	<b>21,319.00</b>	<b>133,823.50</b>

Tabela 9. Paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHJ ( Lot2, PZHRB, 2022)

RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG (LOT 2 - PZHRB 2022)										
LOT 2	Komuna përfituese	Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2022)	Numri I bizneseve përfituese (2022)	Sektorët përfitues	Nr. I projekteve sipas sektorëve	Numri I të punësuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2022)	
	Prizren	46	11	Prodhim	9	41	188,025.00 €	41,243.00 €	229,268.00 €	
				Shërbime	2					
	Dragash	2	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
				Shërbime	0					
	Malishevë	7	2	Prodhim	2	4	38,000.00 €	7,000.00 €	45,000.00 €	
				Shërbime	0					
	Mamushë	1	1	Prodhim	1	1	20,000.00 €	4,500.00 €	24,500.00 €	
				Shërbime	0					
	Rahovec	12	3	Prodhim	3	12	60,000.00 €	37,200.00 €	97,200.00 €	
				Shërbime	0					
	Suharekë	18	2	Prodhim	2	5	40,000.00 €	15,000.00 €	55,000.00 €	
				Shërbime	0					
	<b>Gjithsej: (LOT 2)</b>		<b>86</b>	<b>19</b>	/	<b>19</b>	<b>63</b>	<b>346,025.00</b>	<b>104,943.00</b>	<b>450,968.00</b>



Tabela 10. Paraqitja tabelare e sektorëve të mbështetur nga PZHRB 2022, në RZHJ

RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG	Start Up		LOT 1		Lot 2	
	Prodhim	Shërbim	Prodhim	Shërbim	Prodhim	Shërbim
	12	28	4	10	17	2
<b>Gjithsej:</b>	<b>40</b>		<b>14</b>		<b>19</b>	

Tabela 11. Paraqitja e përgjithshme e investimeve për rajonin zhvillimor Jug PZHRB 2022, (Start Up, Lot1, Lot2).

RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG	Start Up, Lot 1, Lot2	Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2022)	Numri I bizneseve përfituese (2022)	Numri I të punsuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Tot i financimit dhe bashkëfinancimit (2022)
	Start Up	216	40	95	187,246.20 €	35,152.53 €	222,398.73 €
	LOT 1	78	14	33	112,504.50 €	21,319.00 €	133,823.50 €
	LOT 2	86	19	63	346,025.00 €	104,943.00 €	450,968.00 €
	<b>Gjithsej:</b>	<b>380</b>	<b>73</b>	<b>191</b>	<b>645,775.70 €</b>	<b>161,414.53 €</b>	<b>807,190.23 €</b>

**PZHRB (2022)** ka realizuar gjithsej shumën e investime në Rajonin Zhvillimor Jug në vlerën prej **645,775.70€**, me një numër të përgjithshëm prej shtatëdhjetë e tre **73** projekte, nga gjithsej **380** numër të aplikuesëve. Në këtë rajon numri më i madh i aplikuesve është pranuar në Lotin (Start Up), me një numër prej **216** të aplikuesëve apo **40** përfitues, ndërsa në këtë Lot 1, **78** aplikues apo **14** përfitues dhe Lot 2, **86** aplikues apo **19** përfitues në kuadër të Skemës së PZHRB-së për vitin 2022. Ndërkaq numri më i vogël i aplikimeve është pranuar në Lot 1 (biznes ekzistues), me gjithsej (**78**) aplikues. Shuma totale e bashkëfinancimit në Rajonin Zhvillimor Jug është **161,414.53 €** që nënkupton që në RZHJ së bashku me vlerën e financimit prej **645,775.70 €** janë mbështetur projekte në vlerë të përgjithshme prej **807,190.23 €**.


Thesojmë që nga numri i përgjithshëm prej **73** projektesh që janë mbështet në RZHJ, katërdhjetë (**40**) projekte kanë pasë për veprimtari shërbimet, ndërsa tridhjetë e tre (**33**) projekte veprimtarinë e prodhimit.

Në Rajonin Zhvillimor Jug janë punësuar në total **191** persona, ku numri më i madh i të punësuarve është realizuar në kuadër të lotit (Start up) të bizneseve në themelim.


**Komunat në të cilat më shumti është mbështetur sektori privat/bizneset në tre (3) Lote ( Start up, Lot1 dhe Lot2) / janë simëposht:**

- Komuna Prizren, (**54**) projekte përfituese, (**223**) aplikime të pranuar;
- Komuna Rahovec, (**7**) projekte përfituese, (**39**) aplikime të pranuar;
- Komuna Suharekë, (**6**) projekte përfituese, (**42**) aplikime të pranuar.

Grafikoni 4. Paraqitja e tre komunave që kanë përfituar më së shumti në kuadër të Skemës PZHRB-2022, Rajoni Jug



Grafikoni 5. Shpërndarja e Skemës së Granteve PZHRB-2022, Rajoni Jug



### 3.3 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Perëndim

Rajoni Zhvillimor Perëndim përfshinë gjashtë (6) komuna: (Pejë, Klinë, Istog, Junik, Deçan dhe Gjakovë).

Nga Programi për Zhvillim Rajonal në Rajonin Zhvillimor Perëndim, janë përkrahur:

- **61** (gjashtëdhjetë e një) biznese në vlerë prej **597,571.76 €**;

Në kuadër të Skemës (PZHRB - 2022) MZHR ka financuar në RZHP sipas Loteve gjithsej projekte në pesë (5) rajonet zhvillimore të ndara me lotet si vijon:

- Në Lot1 (Start up) janë financuar **32** projekte;
- Në Lot1 (Biznese ekzistuese) janë financuar **10** projekte;
- Në Lot 2 – Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla janë financuar **19** projekte.

Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar - PZHRB (2022) në Rajonin Zhvillimor Perëndim janë pranuar 224 aplikime në tre (3) Lotet (Start Up, Lot1 dhe Lot2) nga gjashtë komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikacioneve prej 224 në kategorinë:

- Në Lot 1 - (Start up) janë pranuar **95** aplikacione;
- Në Lot 2 - (Biznese ekzistuese) janë pranuar **53** aplikacione;
- Lot 2 – Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla janë pranuar **76** aplikacione.

Shuma dhe numri i projekteve të financuara nëpër Lote në RZHP sipas PZHRB (2022) është si vijon:

- Loti 1 (Start Up) – Projekte të reja biznesi:  
Shuma e granteve: nga 2,000.00 € deri në 5,000.00 €;
  - Tridhjetë e dy (**32**) projekte në vlerë **148,132.28**;
- Loti 1 (Ndërmarrjet ekzistuese):  
Shuma e granteve: nga 5,000.01 € deri në 10,000.00 €;
  - Dhjetë (**10**) projekte në vlerë **88,014.56€**.
- Lot 2 – Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla  
Shuma e granteve: 10,000.01 € deri në 20,000.00 €;
  - Nëntëmbëdhjetë (**19**) projekte në vlerë **361,424.92 €**.

Vlerat e bashkëfinancimit nga bizneset përfituese (PZHRB 2022) në RZHP:

- *Kategoria Lot1 (Start up) është bashkëfinancuar në vlerë 27,989.68 €;*
- *Kategoria Lot1 (Biznese ekzistuese) është bashkëfinancuar në vlerë 18,190.12 €;*
- *Kategoria Lot 2 Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla është bashkëfinancuar në vlerë 90,185.00 € ;*

**Totali i bashkëfinancimit për tre lotet në Rajonin Zhvillimor Perëndim është 136,364.8€**

### Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës

Sipas Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2022), në Rajonin Zhvillimor Perëndim, sektori më i financuar është sektori i shërbimit me një numër të projekteve prej (32), duke vijuar me sektorin e prodhimit ku janë financuar gjithsej (29) projekte përfituese.

Punësimi nëpër Lote në RZHP sipas PZHRB (2022) është si vijon:

- *Në Lot1 (Start up) janë shtatëdhjetëepesë (75) të punësuar;*
- *Në Lot1 (Biznese ekzistuese) janë njëzetedy (22) të punësuar;*
- *Në Lot 2 – Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla janë pesëdhjetëetë (58) të punësuar.*

Gjithsej për vitin 2022 në kuadër të PZHRB (2022) janë punësuar **155** persona duke përfshirë Lot1 (Start up), Lot1 (Biznese Ekzistuese) dhe Lot 2 në gjitha komunat përbërëse të këtij rajoni.

Tabela 12. Paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHP (Start Up, PZHRB, 2022)

<b>RAJONI SOCIO-EKONOMIK PERËNDIM (START UP - PZHRB 2022)</b>																																																																							
Ministria e Zhvillimit Rajonal që nga viti i parë i implementimit të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB, ka ofruar qasje të barabartë për të gjitha komunitetet në këtë program. Programi PZHRB ka ofruar mbështetje nga Skema e Grantëve duke stimuluar pjesmarrje për të gjithë përmes financimit të ide projekteve për tre lotet. Në grafikun e mëposhtëm kemi paraqitur pjesmarrjen e komuniteteve përmes projekteve që nga viti 2018 deri në vitin 2022. Pjesmarrja më e madhe sipas projekteve përfituese mbeten *shqiptarët*. Në këtë skemë janë të përfaqësuara edhe komunitetet tjera jo-shumicë edhe pse jo në përqindje shumë të lartë siç janë *serbët, boshnjakët, komuniteti turk, goran dhe Rae*.

Grafiku 25. Paraqitja grafike e shpërndarjes së projekteve sipas etnisë në pesë (5) rajoneve zhvillimore në kuadër të programit mbështetës “PZHRB(2018-2022)”




Nga paraqitja tabelare e mëposhtme ku janë paraqitur numri i përfituesve sipas përkatësisë etnike vërejmë që ka komunitete të cilat në kuadër të programit “PZHRB-2022”, nuk kanë përfituar nga ky program mbështetës sikurse komuniteti goran si dhe ai rom dhe ashkali. Nga ky program përfituesit më të shumtë në numër janë shqiptarët me gjithsej **287** përfitues, pastaj komuniteti turk **26** përfitues, boshnjak **9** përfitues dhe **9** serb dhe egjiptas 1 përfitues nga totali prej **332** përfituesve të PZHRB-së.

Tabela 30,. Paraqitja tabelare e shpërndarjes së mjeteve financiare sipas përkatësisë etnike, në pesë pesë (5) rajone zhvillimore (PZHRB 2021)

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar – PZHRB (2022) (Start Up ,Lot1 dhe Lot 2)							
Pesë(5) Rajonet Zhvillimore	Përkatësia Etnike						Gjithsej numri i përfituesëve
	Viti	Shqiptar	Serb	Boshnjak	Turk	Goran	
	2022	287	9	9	26	0	1
Gjithsej numri i përfituesëve		332					332


Grafiku 26. Paraqitja grafike shpërndarjes së projekteve sipas përkatësisë etnike PZHRB (2022)



## VII. Projektet përfituese nga gratë për vitin 2022, Programi “PZHRB”

MZHR ka mbështetur vazhdimisht bizneset e udhëhequra nga gratë në tre Lotet e programit PZHRB që nga viti 2018 deri më tani duke ndikuar në hapjen e ndërmarrjeve të reja, duke stimuluar qëndrueshmërinë e tyre dhe zgjerimin e kapaciteteve të bizneseve. Gjithashtu mbetet një përkushtim çdoherë stimulimi i ideve inovative në kuadër të Start Up-ve. Që nga fillimi implementimit të programit projektet nga gratë kanë pasur rritje të konsiderueshëm me pjesëmarrjen e tyre përmes projekteve në këtë program. Më poshtë në grafikun kemi paraqitur numrin e projekteve të udhëhequra nga gratë për periudhën 2018-2022.

*Grafiku 27. Paraqitja grafike e shpërndarjes së projekteve përfituese nga gratë në pesë (5) rajoneve zhvillimore në kuadër të programit mbështetës “PZHRB 2018-2022”*





## 7.1 Shpërndarja e projekteve përfituese të udhëhequra nga gratë (Start Up, Lot1 dhe Lot 2), PZHRB 2022

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar, për vitin 2022 ka mbështetur financiarisht **(134)** biznese të udhëhequra nga gratë dhe **(198)** biznese të udhëhequra nga burrat. Numri më i madh i projekteve të financuara nga gratë është në Rajonin Zhvillimor Qendër me gjithsej **37** projekte përfituese, ndërsa Rajoni Zhvillimor Jug dhe Perëndim kanë numër të barabartë përfituesesh gra me një numër prej **24** përfituesve në secilin rajon. Gjithashtu Rajoni Zhvillimor Lindje është rajoni i dytë me radhë për nga mbështetja e grave me një numër prej **30** bizneseve. Duke veçuar lotet të cilat mbështeten nga Skema PZHRB - 2022, në Lotin Start Up kemi numrin më të madh të përfituesëve gra prej **87**, duke vijuar me Lot 1 (26) përfituese dhe Lot 2 (21) përfituese.



<b>PESË (5) RAJONET ZHVILLIMORE</b>	<b>NUMRI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTEVE</b>
Rajoni socio Ekonomik Qendër	37
Rajoni Socio-Ekonomik Jug	24
Rajoni socio- Ekonomik Perëndim	24
Rajoni Socio-Ekonomik Veri	19
Rajoni Socio –Ekonomik Lindje	30
<b>GJITHSEJ:</b>	<b>134</b>


Tabela 31. Paraqitja tabelare e shpërndarjes së projekteve të udhëhequra nga gratë në pesë (5) rajone zhvillimore (PZHRB-2022)

<b>Gjinia më e përfaqësuar në pesë (5) rajone zhvillimore</b>	<b>Grua</b>			<b>Burrë</b>		
	Nr. Projektit	%	Vlera financiare e investuar	Nr. Projektit	%	Vlera financiare e investuar
<b>Start Up</b>	87	65%	€ 397,647.87	98	49%	€ 460,067.24
<b>Lot 1</b>	26	19%	€ 224,324.10	34	17%	€ 301,015.96
<b>Lot 2</b>	21	16%	€ 392,911.52	66	33%	€ 1,254,967.40
<b>Gjithsej</b>	134	100%	€ 1,014,883.49	198	100%	€ 2,016,050.60

Tabela 32. Shpërndarja tabelare e projekteve sipas gjinisë (PZHRB-2022)


Gjinia më e përfaqësuar në pesë (5) rajone zhvillimore	Grua			Burrë		
	START UP					
	Nr. Projektit	%	Vlera financiare e investuar	Nr. Projektit	%	Vlera financiare e investuar
Qendër	25	29%	€ 113,124.00	18	18%	€ 87,199.10
Jug	15	17%	€ 67,988.00	25	26%	€ 119,258.20
Perendim	14	16%	€ 65,058.28	18	18%	€ 83,074.00
Veri	15	17%	€ 72,053.24	15	15%	€ 66,699.80
Lindje	18	21%	€ 79,424.35	22	22%	€ 103,836.14
Gjithsej	87	100%	€ 397,647.87	98	100%	€ 460,067.24

Tabela 33. Shpërndarja e projekteve përfituese nga gratë, Kategoria Start Up, PZHRB- 2022



Grafikoni 28. Paraqitja grafike në përqindje e përfitusëve gra, në Kategorinë START UP, PZHRB 2022

Vlen të theksohet se këtë vit në rajonin Qendër në kategorinë Start Up kemi përqindjen më të madhe të përfaqësimit të projekteve përfituese nga gratë me 61% të projekteve përfituese nga totali në krahasim me projektet e përfituar nga burrat 39%. Ky është një progres shumë i madh i Skemës së Granteve lidhur me objektivat në ndikimin e ndërmarrësisë tek gratë.



Grafikoni 29. Paraqitja grafike në përqindje e përfitusëve gra, në Kategorinë START UP, PZHRB 2022


Mëposhtë janë paraqitur projektet përfituese nga gratë në kategorinë Lot 1, PZHRB në bazë të pesë rajoneve zhvillimore (Qendër, Jug, Perendim, Veri dhe Lindje). Gjinia më e përfaqësuar në pesë (5 ) rajone zhvillimore sipas këtij loti është përfaqësimi nga burrat me 34 projekte në total, në krahasim me gratë me gjithsej 26 projekte të përfituara nga Skema e Grantëve PZHRB. Në formë tabelare gjeni shpërndarjen në total të projekteve të këtij Loti.

Tabela 34. Shpërndarja e projekteve përfituese nga gratë, Kategoria LOT 1, PZHRB -2022

Gjinia më e përfaqësuar në pesë (5 ) rajone zhvillimore	Grua		Burrë	
	LOT 1			
	Nr. Projektit	Vlera financiare e investuar	Nr. Projektit	Vlera financiare e investuar
Qendër	10	€ 89,209.60	8	€ 75,605.39
Jug	6	€ 43,464.50	8	€ 69,040.00
Perendim	2	€ 18,700.00	8	€ 69,314.56
Veri	1	€ 8,940.00	3	€ 26,147.01
Lindje	7	€ 64,010.00	7	€ 60,909.00
Gjithsej	26	€ 224,324.10	34	€ 301,015.96

Në formë grafike kemi paraqitur në përqindje përfaqësimin e dy gjinive të projekteve përfituese Lot 1 nga Programi PZHRB-2022. Vërejmë që kemi një përfaqësim gati të balancuar sa i përket projekteve përfituese të ndara nga kjo Skemë. MZHR vazhdon mbështetjen ndaj grave përmes implementimit të programeve të saj.

Grafikoni 30. Paraqitja grafike në përqindje e përfituesëve gra, në Kategorinë LOT 1, PZHRB - 2022




Në formë tabelare janë paraqitur projektet përfituese nga gratë edhe në kategorinë Lot 2, të programit PZHRB-2022 në bazë të pesë rajoneve zhvillimore (Qendër, Jug, Perendim, Veri dhe Lindje). Gjinia më e përfaqësuar në pesë (5 ) rajone zhvillimore sipas këtij loti është përfaqësimi nga burrat me 66 projekte në total, në krahasim me gratë me gjithsej 21 projekte të përfituara nga Skema e Granteve PZHRB. Në formë tabelare gjeni shpërndarjen në total të projekteve të këtij Loti.

Tabela 35. Shpërndarja e projekteve përfituese nga gratë, Kategoria LOT 2, PZHRB- 2022

Gjinia më e përfaqësuar në pesë (5 ) rajone zhvillimore	Grua		Burrë	
	LOT 2			
	Nr. Projektit	Vlera financiare e investuar	Nr. Projektit	Vlera financiare e investuar
Qendër	2	€ 39,801.60	16	€ 308,850.00
Jug	3	€ 55,175.00	16	€ 290,850.00
Perendim	8	€ 147,934.92	11	€ 213,490.00
Veri	3	€ 53,000.00	9	€ 177,627.40
Lindje	5	€ 97,000.00	14	€ 266,150.00
Gjithsej	21	€ 392,911.52	66	€ 1,256,967.40

Në formë grafike kemi paraqitur në përqindje përfaqësimin e dy gjinive të projekteve përfituese Lot 2 nga Programi PZHRB-2022. Këtu vërejmë që kemi një përfaqësim jo-mirë të balancuar sa i përket projekteve përfituese të ndara nga kjo Skemë. Diferenca e përfaqësimit sipas përqindjeve është shumë e lartë mes të dy gjinive në këtë Lot. Projektet përfituese nga burrat përbëjnë 76% të totalit në krahasim me gratë të cilat përfaqësohen me 24% të projekteve përfituese.

Grafikoni 31. Paraqitja grafike në përqindje e përfituesëve gra në Kategorinë LOT 2, PZHRB- 2022



## VIII. Programi për përkrahjen e NMVM-ve 2022 nga MINT

Sipas konfirmimeve nga MINT, Agjencia KIESA gjatë vitit 2021, ka shpallur thirrjen publike për subvencionim të NVM-ve për blerjen e makinerive prodhuese /përpunuese sipas kategorive, mirëpo lista përfundimtare e përfituesve është publikuar në fillim të vitit 2022 dhe implementimi është realizuar gjatë v.2022. Mëposhtë do të pasqyrojmë të gjitha projektet përfituese sipas pesë rajoneve zhvillimore që janë zbatuar në v.2022. Për korrektësi Departamenti i Ndërmarrësisë i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më datë 26.08.2021 e ka shpallur thirrjen publike për financimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme në fusha specifike dhe duke u bazuar në raportin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave në MINT, e njëjta thirrje është anuluar sipas vendimit të datës 18.01.2022 me Nr. protokoll: 296/02. Synimi i përgjithshëm i thirrjes është fuqizimi i sektorit privat, rritja e konkurrueshmërisë dhe përmirësimi i gjendjes socio ekonomike në vend. Poashtu kjo thirrje ka për qëllim edhe zvogëlimin e bilancit tregtar dhe përmirësimin e kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), rritjen e investimeve, rritjen eksportit, konkurrueshmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Poashtu me qëllim të përkrahjes së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në funksion të fuqizimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës, Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë MINT ka shpallur vitet e mëhershme programet (fondet) për Inovacion dhe Ndërmarrësi për financimin e Bizneseve Fillestare – “Start-up” i cili program ka qenë i dizajnuar për të financuar bizneset e reja dhe iniciativat/idetë për krijimin e bizneseve të reja inovative me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Financimi i “Start-Up” synon fuqizimin ekonomik të të rinjve në jetësimin e ideve inovative dhe planeve të bizneseve. Nga konfirmimi që kemi pranuar nga Departamenti i Inovacionit skemat e granteve dhe buxheti që është paraparë për kategorinë Start Up dy vitet e fundit (2021 dhe 2022) është destinuar për veprimtari të tjera dhe nuk ka pas buxhet për të lancuar thirrje publike.

Ministria e Inovacionit, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për v.2022 ka implementuar shumën totale prej 398,045.92 € të shpërndarë në pesë (5) rajone zhvillimore ku sektori privat/bizneset janë mbështetur në sektorin e prodhimit dhe përpunimit.

---


<sup>2</sup> Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Tabela 36. Skema e grante MINT (2022) sipas pesë(5) rajoneve zhvillimore


Përfituesit e granteve për biznese v.2021 nga Ministria e Inovacionit, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për v.2022						
Rajonet zhvillimore	Komunat	Ndërmarrjet et mikro (1 deri 9 punëtor)	Ndërmarrjet et e vogla (10 deri 49 punëtor)	Ndërmarrjet et e mesme ( 50 deri 249 punëtor)	Veprimtaria ( prodhim/shërbime)	Vlera e shpenzuar e projektit për v.2022
<b>QENDËR</b>	Prishtinë	1	1	1	Prodhues	43,866.30
	Drenas	-	-	-	-	-
	Fushë Kosovë	-	1	-	Prodhues	15,000.00
	Graçanicë	-	-	-	-	-
	Lipjan	1	-	1	Prodhues/Përpunues	38,474.59
	Obiliq	2	-	-	Prodhues	19,950.00
	Podujevë	-	-	-	-	-
	Shtime	-	2	-	-	40,000.00
<b>TOTALI QENDËR</b>		<b>4</b>	<b>4</b>	<b>2</b>		<b>157,290.89€</b>
<b>JUG</b>	Prizren	1	-	-	-	7,752.00
	Dragash	-	-	-	-	-
	Malishevë	1	-	-	-	10,000.00
	Mamushë	-	-	-	-	-
	Rahovec	-	-	-	-	-
	Suharekë	-	-	-	-	-
	<b>TOTALI JUG</b>		<b>2</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	
<b>LINDJE</b>	Gjilan	-	-	-	-	-
	Novobërdë	-	-	-	-	-
	Kamenicë	-	-	-	-	-
	Ferizaj	2	-	3	Prodhues	68,830.50
	Kaçanik	1	-	-	Prodhues	10,000.00
	Shtërpcë	1	-	-	Prodhues	6,175.00
	Viti	-	-	-	-	-
	Hani i Elezit	-	-	-	-	-
	Kllokot	-	-	-	-	-
	Ranillugë	-	-	-	-	-
	Partesh	-	-	-	-	-
<b>TOTALI LINDJE</b>		<b>4</b>	<b>-</b>	<b>3</b>		<b>85,005.50€</b>
<b>PERËNDIM</b>	Pejë	1	-	-	Prodhues	4,092.50
	Istog	3	-	-	Prodhues	23,861.40
	Deçan	-	-	-	-	-
	Junik	-	-	-	-	-
	Klinë	-	-	-	-	-
	Gjakovë	3	1	1	Prodhues	43,101.63
<b>TOTALI PERËNDIM</b>		<b>7</b>	<b>1</b>	<b>1</b>		<b>71,055.53€</b>
<b>VERI</b>	Mitrovicë	1	-	-	Prodhues	7,000.00

	<b>Skenderaj</b>	-	1	-	Prodhues/Përpunues	20,000.00
	<b>Vushtrri</b>	-	2	-	Prodhues	39,942.00
	<b>Mitrovica e V.</b>	-	-	-	-	-
	<b>Leposaviq</b>	-	-	-	-	-
	<b>Zveqan</b>	-	-	-	-	-
	<b>Zubin Potok</b>	-	-	-	-	-
<b>TOTALI VERI</b>		<b>1</b>	<b>3</b>	<b>-</b>		<b>66,942.00€</b>
<b>TOTALI I PËRFITUESËVE</b>		<b>18</b>	<b>8</b>	<b>6</b>		<b>398,045.92 €</b>

Grafiku 32. Paraqitja e implementimit të Programit të Granteve nga MINT 2022



Grafiku 33. Paraqitja e implementimit të Programit (%) të Granteve nga MINT 2022



## X. Programi për Zhvillim Rural për vitin 2022 nga MBPZHR

Programi për zhvillim rural është i bazuar në Strategjinë për Bujqësi<sup>3</sup> dhe Zhvillim Rural 2022-2028, Ligjin Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, Ligjin Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, dhe Ligjin Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022. Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural/Autoriteti Menaxhues (AM) ka përgatitur Programin e Zhvillimit Rural 2022 dhe është i bazuar në analizën e pavarur sektoriale për sektorët kryesor të bujqësisë dhe zhvillimit rural, të financuar nga zyra e BE në Kosovë:

- Sektori i bimëve /drithërat, pemët dhe perimet – prodhimi, përpunimi dhe tregtimi në tërë zinxhirin;
- Sektori i Blegtorisë (mishi, qumësht, vezë) – prodhimi, përpunimi dhe tregtimi në tërë zinxhirin
- Diversifikimi rural dhe zhvillimi i ekonomisë rurale, duke përfshirë marketingun në tërë zinxhirin, arritja e standardeve përkatëse kombëtare dhe të BE –së, si dhe përafrimi me marrëveshjen e Gjelbër të BE-së.

Sipas analizave të përmbledhura; analizës SWOT dhe analizës sektoriale, janë përcaktuar objektivat afatmesme të PZHR-së, të cilët janë:

- Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor duke përmirësuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e prodhimit në fermë, duke tërhequr fermerët e rinj, duke orientuar prodhimin sipas kërkesave të tregut, duke përmirësuar zinxhirin e vlerës dhe duke u fokusuar në kërkimin, inovacionin, teknologjinë e re dhe digjitalizimin;
- Të sigurojë përgjigje më të mirë ndaj kërkesave të shoqërisë për ushqim të sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, duke kontribuar me një pjesë më të madhe në prodhimin vendor; • Mbrojtja e burimeve natyrore dhe mjedisore, të cilat adresojnë sfidat e ndryshimeve klimatike duke arritur përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- Përmirësimi i cilësisë së jetës, zhvillimi i komunitetit dhe përfshirja sociale në zonat rurale dhe ndërtimi i administratave publike moderne, duke respektuar parimet e qeverisjes së mirë.

---

3 2022\_07\_19\_095835\_Programi\_\_per\_zhvillim\_rural\_2022.pdf



Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në baza vjetore e mbështet sektorin e bujqësisë dhe zhvillimin rural, përmes granteve investive, investimeve kapitale dhe skemës së pagesave direkte. Masat e programit të zhvillimit rural të cilat janë në proces të zbatimit përfshijnë: Avancimin e kapitali fizik, adaptimin e praktikave të mira të prodhimit, rritjen e prodhimit dhe produktivitetit, përmirësimin e cilësisë dhe zhvillimin e sistemeve të sigurisë së ushqimit, etj. <sup>4</sup>

Objektivat strategjike të PBZHR, kanë të bëjnë me: Rritjen e aftësisë konkurruese të sektorit agro-ushqimor, që bazohet në përdorimin e teknologjisë moderne, rritjen e prodhimit, të produktivitetit dhe sigurisë së ushqimit për të qenë konkurrent në tregun e brendshëm e të jashtëm, si dhe në zvogëlimin e bilancit negativ tregtar; Përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve në zonat rurale nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve në ferma dhe jashtë fermave me qëllim të krijimit të vendeve të punës dhe rritjes së të ardhurave; Mbrojtjen e mjedisit dhe resurseve natyrore, nëpërmjet investimeve në ujitje, kullim, trajtim të mbetjeve, si dhe energji të ripërtëritshme. Zbatimi i Programit për Zhvillim Rural, bëhet në baza vjetore dhe realizohet përmes masave dhe nën masave, si në vijim:

- MASA 1: INVESTIMET NË ASETET FIZIKE TË EKONOMIVE BUJQËSORE;
- MASA 3: INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE;
- MASA 7: DIVERSIFIKIMI I FERMËS DHE ZHVILLIMI I BIZNESIT;
- MASA 5: PËRGATITJA ZBATIMI I STRATEGJIVE TË ZHVILLIMIT LOKAL – QASJA LEADER

Tabela 37. Buxhetimi i PZHR sipas Masave për vitin.2022

MASAT	2022	BUXHETI	%
<b>Masa 1</b>	Investimet në asete fizike dhe në ekonomitë bujqësore	13,095,325.00	49.73
<b>Masa 3</b>	Investime në asete fizike në përpunim dhe tregtimin e produkteve bujqësore	5,836,473.68	22.16
<b>Masa 7</b>	Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Bizneseve	7,200,000.00	27.34
<b>Masa 5</b>	Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal – “Qasja Leader”	200,000.00	0.75
	<b>Totali i Buxhetit</b>	<b>26,331,798.68</b>	<b>100</b>

<sup>4</sup> Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Sa i përket masave preferenciale të zbatuara në Program: Përparësi kanë pasur projektet që kanë trajtuar ruajtjen e ambientit, përdorimin e energjisë së ripërtëritshme, angazhimin e të rinjve, aplikantet femra dhe zonat e larta rurale (mbi 700 m).

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural, përkatësisht Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural/Autoriteti Menaxhues (DPZHR/AM) është përgjegjës për përgatitjen, monitorimin dhe vlerësimin, raportimin, menaxhimin financiar, informimin dhe publicitetin si dhe koordinimin e përgjithshëm të programit. Ndërsa zbatimi i PZHR bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë që është Agjenci ekzekutive në kuadër të MBPZHR-së.

Përfitues të Programit të Zhvillimit Rural janë:

- Ekonomitë bujqësore/personat fizik dhe juridik të regjistruar në Regjistrin e Fermave;
- Operatorët e ushqimit (përpunimi dhe/ose tregtimi i produkteve bujqësore) të regjistruar në bazë të Ligjit për Investime të Huaja dhe Ligjit për ushqim (103) dhe Ligjit për shoqëritë tregtare;
- Ndërmarrjet jobujqësore në zonat rurale të regjistruara sipas Ligjit për shoqëritë tregtare dhe ligjit për Zejtari;
- Personat fizik dhe juridik në zonat rurale të regjistruar sipas Ligjit për veprimtaritë hoteliere dhe turistike;
- Grupet Lokale të Veprimit/GLV të regjistruara në MAP në bazë të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural dhe Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare;
- Kompanitë Publike Rajonale të Ujitjes.

Në tabelat e mëposhtme është pasqyruar shpërndarja e financimit dhe projekteve përfituese të Skemes së Granteve (Programi për Zhvillim Rural) v.2022 implementuar nga MBPZHR sipas pesë(5) rajoneve zhvillimore me të cilat operon Ministria e Zhvillimit Rajonal në kontekst të avancimit socio ekonomik të rajoneve zhvillimore. MBPZHR ka financuar një vlerë totale prej **17,425,438.89€** duke implementuar një numër prej **346** projektesh në total. Rajoni Zhvillimor që ka përfituar më së shumti financime nga kjo skemë është RZHP (27%), duke vijuar me me

një përqindje të barabartë prej 20% të financimit në RZHL dhe RZHJ, 18% të skemes së granteve i ka përfituar RZHV ndërsa rajoni që ka përfituar më pak në krahasim me rajonet tjera është RZHL me një përqindje prej 15%. Vlen të theksohet që një shpërndarje mjaft të balancuar MBPZHR ka realizuar edhe brenda komunave të rajoneve përbërëse ku figurojnë rajone zhvillimore që kanë përfituar të gjitha komunat përbërëse të atij rajoni si RZHP dhe RZHJ dhe mbi 80% e komunave janë përfituese nga gjitha rajonet tjera zhvillimore.

Zbatimi i Programit për Zhvillim Rural bëhet në baza vjetore dhe realizohet përmes masave dhe nën masave. Masa 1 që ka të bëjë me “Investimet në asete fizike dhe në ekonominë bujqësore” ka mbështetur 246 projekte në vlerën 13,505,396.30€ apo 70% të buxhetit të përgjithshëm, +Masa 7 “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve” në kuadër të së cilës janë mbështetur 88 projekte apo në vlerë financiare 2,861,929.19€, duke vijuar me Masen 3”Investimet në asete fizike në përpunim dhe tregtimin e produkteve bujqësore” ku janë mbështetur gjashtë (6) projekte në vlerë totale 998,418.40€ dhe e fundit është Masa 5” Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal – “Qasja Leader” në të cilën masë janë financuar gjashtë (6) projekte në vlerën 59,695.00 €.


Për sqarime shtesë dhe korrektësi numri dhe vlera e projekteve të kontraktuara prezanton gjendjen deri më 28.02.2023 duke qenë se relizimi i PZHR 2022 është ende duke vazhduar.

Tabela 38. Paraqitja tabelare e përfituesve sipas rajoneve dhe komunave PZHR 2022, implementuar nga MBPZHR

Rajoni	Komuna	Numri i projekteve të kontraktuara	Vlera e projekteve (aplikimet)	Vlera e projekteve të kontraktuara	Vlera e përkrahjes për projektet e kontraktuara
<b>VERI</b>	Mitrovicë	7	432,344.88	374,840.38	243,405.77
	Skenderaj	24	2,185,281.14	2,116,865.48	1,475,136.79
	Vushtrri	26	1,933,679.30	1,791,233.23	1,213,439.43
	Zubin Potok	3	228,100.00	199,005.07	135,066.26
	Zveqan	1	100,000.00	99,800.00	69,860.00
<b>VERI Total</b>		<b>61</b>	<b>4,879,405.32</b>	<b>4,581,744.16</b>	<b>3,136,908.25</b>
<b>PERËNDIM</b>	Deçan	7	585,529.85	554,494.29	375,623.30
	Gjakovë	10	785,596.48	653,931.47	454,340.16
	Istog	25	1,980,967.97	1,836,872.26	1,255,653.31
	Junik	1	100,000.00	99,162.00	69,413.40
	Klinë	10	837,164.00	726,804.50	503,963.15
	Pejë	37	3,212,603.82	3,022,978.05	1,960,954.07

<b>PERËNDIM</b>					
<b>Total</b>		<b>90</b>	<b>7,501,862.12</b>	<b>6,894,242.57</b>	<b>4,619,947.39</b>
<b>LINDJE</b>	Ferizaj	13	997,340.50	938,269.00	640,097.00
	Gjilan	9	694,235.00	636,455.21	440,953.21
	Hani i Elezit	1	99,996.18	96,050.50	67,235.35
	Kaçanik	1	172,386.50	172,386.50	86,193.25
	Kamenicë	16	1,215,347.00	1,135,802.40	759,502.93
	Novobërdë	5	680,267.29	671,830.79	382,688.75
	Shtërpce	1	93,000.00	92,000.00	55,200.00
	Viti	5	355,975.00	326,930.00	231,843.50
<b>LINDJE Total</b>		<b>51</b>	<b>4,308,547.47</b>	<b>4,069,724.40</b>	<b>2,663,713.99</b>
<b>JUG</b>	Dragash	5	409,840.70	387,245.50	260,427.30
	Malishevë	6	712,982.02	684,140.05	392,264.46
	Mamushë	23	1,577,100.00	1,565,848.75	1,096,094.13
	Prizren	7	735,950.00	670,215.00	409,290.53
	Rahovec	18	1,106,741.00	995,683.10	687,704.42
	Suharekë	13	1,036,730.00	939,943.12	652,673.58
<b>JUG Total</b>		<b>72</b>	<b>5,579,343.72</b>	<b>5,243,075.52</b>	<b>3,498,454.42</b>
<b>QENDËR</b>	Drenas	8	614,455.70	516,382.76	346,207.03
	Fushe Kosovë	4	249,758.40	232,812.46	158,599.51
	Lipjan	8	575,734.28	555,523.01	384,513.31
	Obiliq	2	161,748.00	148,716.00	104,101.20
	Podujevë	27	2,435,362.05	2,179,690.02	1,431,781.60
	Prishtinë	16	1,248,937.50	1,147,127.40	760,255.89
	Shtime	7	713,743.72	550,798.71	320,956.30
<b>QENDËR Total</b>		<b>72</b>	<b>5,999,739.65</b>	<b>5,331,050.36</b>	<b>3,506,414.84</b>
<b>Grand Total</b>		<b>346</b>	<b>28,268,898.28</b>	<b>26,119,837.01</b>	<b>17,425,438.89</b>

Grafikoni 34. Paraqitja e PZHR-së (2022) sipas pesë rajoneve në vlera të financimit dhe projekte



Grafikoni 35. Shpërndarja e balancuar në % e financimit dhe projekteve sipas pesë rajoneve zhvillimore, PZHR (2022)




Tabela 39. Paraqitja tabelare në % e përfituesve sipas rajoneve dhe Masave në komuna PZHR 2022, implementuar nga MBPZHR

Masa	Rajoni	Komuna	Numri i projekteve të kontraktuara	Vlera e projekteve (aplikimet)	Vlera e projekteve të kontraktuara	Vlera e përkrahjes për projektet e kontraktuara	% e mbështetjes
<b>Masa 1: Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore</b>	VERI	Mitrovicë	3	242,344.88	185,015.38	129,510.77	70%
		Skenderaj	22	2,105,281.14	2,050,174.98	1,435,122.49	70%
		Vushtrri	17	1,490,079.30	1,386,995.00	970,896.50	70%
		Zubin Potok	2	178,100.00	156,632.19	109,642.53	70%
		Zveqan	1	100,000.00	99,800.00	69,860.00	70%
	<b>VERI Total</b>		<b>45</b>	<b>4,115,805.32</b>	<b>3,878,617.55</b>	<b>2,715,032.29</b>	<b>70%</b>
	PERËNDIM	Deçan	5	460,231.60	429,267.29	300,487.10	70%
		Gjakovë	8	747,396.48	619,812.72	433,868.91	70%
		Istog	19	1,661,001.69	1,535,299.51	1,074,709.66	70%
		Junik	1	100,000.00	99,162.00	69,413.40	70%
		Klinë	8	778,164.00	678,804.50	475,163.15	70%
		Pejë	18	1,604,073.00	1,431,672.30	1,002,170.62	70%
		<b>PERËNDIM Total</b>		<b>59</b>	<b>5,350,866.77</b>	<b>4,794,018.32</b>	<b>3,355,812.84</b>
	LINDJE	Ferizaj	8	744,610.50	732,436.00	512,705.20	70%
		Gjilan	7	646,605.00	590,800.86	413,560.60	70%
		Hani i Elezit	1	99,996.18	96,050.50	67,235.35	70%
		Kamenicë	10	857,094.00	780,214.90	546,150.43	70%
		Novobërdë	2	199,940.00	195,140.00	136,598.00	70%
		Viti	4	346,000.00	316,955.00	221,868.50	70%
		<b>LINDJE Total</b>		<b>32</b>	<b>2,894,245.68</b>	<b>2,711,597.26</b>	<b>1,898,118.08</b>
	JUG	Dragasht	3	283,000.00	280,800.00	196,560.00	70%
		Malishevë	3	242,982.02	217,804.25	152,462.98	70%
		Mamushtë	23	1,577,100.00	1,565,848.75	1,096,094.13	70%
		Prizren	4	390,000.00	333,815.25	233,670.68	70%
		Rahovec	16	1,006,741.00	902,945.60	632,061.92	70%
		Suharekë	11	976,730.00	887,077.12	620,953.98	70%
		<b>JUG Total</b>		<b>60</b>	<b>4,476,553.02</b>	<b>4,188,290.97</b>	<b>2,931,803.69</b>


	QENDËR	Drenas	5	454,885.70	363,773.76	254,641.63	70%
		Fushe Kosovë	2	199,758.40	189,120.34	132,384.24	70%
		Lipjan	5	487,331.03	471,995.00	330,396.50	70%
		Obiliq	2	161,748.00	148,716.00	104,101.20	70%
		Podujevë	21	1,878,854.30	1,639,675.82	1,147,773.08	70%
		Prishtinë	11	820,173.50	719,794.50	503,856.15	70%
		Shtime	4	273,781.72	187,823.71	131,476.60	70%
	<b>QENDËR Total</b>		<b>50</b>	<b>4,276,532.65</b>	<b>3,720,899.13</b>	<b>2,604,629.40</b>	<b>70%</b>
<b>Masa 1: Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore Total</b>			<b>246</b>	<b>21,114,003.44</b>	<b>19,293,423.23</b>	<b>13,505,396.30</b>	<b>70%</b>
Masa 3: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore	LINDJE	Kaçanik	1	172,386.50	172,386.50	86,193.25	50%
		Novobërdë	1	399,237.29	399,237.29	199,618.65	50%
	<b>LINDJE Total</b>		<b>2</b>	<b>571,623.79</b>	<b>571,623.79</b>	<b>285,811.90</b>	<b>50%</b>
	JUG	Malishevë	1	400,000.00	400,000.00	200,000.00	50%
		Prizren	1	305,950.00	302,200.00	151,100.00	50%
	<b>JUG Total</b>		<b>2</b>	<b>705,950.00</b>	<b>702,200.00</b>	<b>351,100.00</b>	<b>50%</b>
	QENDËR	Podujevë	1	400,000.00	400,000.00	200,000.00	50%
		Shtime	1	400,000.00	323,013.00	161,506.50	50%
	<b>QENDËR Total</b>		<b>2</b>	<b>800,000.00</b>	<b>723,013.00</b>	<b>361,506.50</b>	<b>50%</b>
	<b>Masa 3: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore Total</b>			<b>6</b>	<b>2,077,573.79</b>	<b>1,996,836.79</b>	<b>998,418.40</b>
Masa 5: Përgatitja zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal – qasja LEADER	PERËNDIM	Pejë	1	10,000.00	10,000.00	10,000.00	100%
	<b>PERËNDIM Total</b>		<b>1</b>	<b>10,000.00</b>	<b>10,000.00</b>	<b>10,000.00</b>	<b>100%</b>
	LINDJE	Ferizaj	1	9,730.00	9,730.00	9,730.00	100%
		Viti	1	9,975.00	9,975.00	9,975.00	100%
	<b>LINDJE Total</b>		<b>2</b>	<b>19,705.00</b>	<b>19,705.00</b>	<b>19,705.00</b>	<b>100%</b>

	JUG	Prizren	1	10,000.00	10,000.00	10,000.00	100%
	<b>JUG Total</b>		<b>1</b>	<b>10,000.00</b>	<b>10,000.00</b>	<b>10,000.00</b>	<b>100%</b>
	QENDËR	Lipjan	1	10,000.00	10,000.00	10,000.00	100%
		Shtime	1	9,990.00	9,990.00	9,990.00	100%
	<b>QENDËR Total</b>		<b>2</b>	<b>19,990.00</b>	<b>19,990.00</b>	<b>19,990.00</b>	<b>100%</b>
<b>Masa 5: Përgatitja zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal – qasja LEADER Total</b>			<b>6</b>	<b>59,695.00</b>	<b>59,695.00</b>	<b>59,695.00</b>	<b>100%</b>
<b>Masa 7: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve</b>	VERI	Mitrovicë	4	190,000.00	189,825.00	113,895.00	60%
		Skenderaj	2	80,000.00	66,690.50	40,014.30	60%
		Vushtrri	9	443,600.00	404,238.23	242,542.93	60%
		Zubin Potok	1	50,000.00	42,372.88	25,423.73	60%
	<b>VERI Total</b>		<b>16</b>	<b>763,600.00</b>	<b>703,126.61</b>	<b>421,875.96</b>	<b>60%</b>
	PERËNDIM	Deçan	2	125,298.25	125,227.00	75,136.20	60%
		Gjakovë	2	38,200.00	34,118.75	20,471.25	60%
		Istog	6	319,966.28	301,572.75	180,943.65	60%
		Klinë	2	59,000.00	48,000.00	28,800.00	60%
		Pejë	18	1,598,530.82	1,581,305.75	948,783.45	60%
	<b>PERËNDIM Total</b>		<b>30</b>	<b>2,140,995.35</b>	<b>2,090,224.25</b>	<b>1,254,134.55</b>	<b>60%</b>
	LINDJE	Ferizaj	4	243,000.00	196,103.00	117,661.80	60%
		Gjilan	2	47,630.00	45,654.35	27,392.61	60%
		Kamenicë	6	358,253.00	355,587.50	213,352.50	60%
		Novobërdë	2	81,090.00	77,453.50	46,472.10	60%
		Shtërpce	1	93,000.00	92,000.00	55,200.00	60%
	<b>LINDJE Total</b>		<b>15</b>	<b>822,973.00</b>	<b>766,798.35</b>	<b>460,079.01</b>	<b>60%</b>
	JUG	Dragash	2	126,840.70	106,445.50	63,867.30	60%
		Malishevë	2	70,000.00	66,335.80	39,801.48	60%
		Prizren	1	30,000.00	24,199.75	14,519.85	60%
Rahovec		2	100,000.00	92,737.50	55,642.50	60%	



		Suharekë	2	60,000.00	52,866.00	31,719.60	60%
	<b>JUG Total</b>		<b>9</b>	<b>386,840.70</b>	<b>342,584.55</b>	<b>205,550.73</b>	<b>60%</b>
	<b>QENDËR</b>	Drenas	3	159,570.00	152,609.00	91,565.40	60%
		Fushe Kosovë	2	50,000.00	43,692.12	26,215.27	60%
		Lipjan	2	78,403.25	73,528.01	44,116.81	60%
		Podujevë	5	156,507.75	140,014.20	84,008.52	60%
		Prishtinë	5	428,764.00	427,332.90	256,399.74	60%
		Shtime	1	29,972.00	29,972.00	17,983.20	60%
	<b>QENDËR Total</b>		<b>18</b>	<b>903,217.00</b>	<b>867,148.23</b>	<b>520,288.94</b>	<b>60%</b>
<b>Masa 7: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve Total</b>			<b>88</b>	<b>5,017,626.05</b>	<b>4,769,881.99</b>	<b>2,861,929.19</b>	<b>60%</b>
<b>Grand Total</b>			<b>346</b>	<b>28,268,898.28</b>	<b>26,119,837.01</b>	<b>17,425,438.89</b>	

### Programi për Zhvillim Rural (2022) Implementimi i Masave



## XI. Shpërndarja e balancuar e investimeve për mbështetjen e sektorit privat nga MZHR dhe Ministrinë e Linjës

Në grafikonet e mëposhtëm është paraqitur shpërndarja e balancuar e mbështetjes së sektorit privat nga ML sipas pesë (5) rajoneve zhvillimore me të cilat operon dhe zbaton mandatin e saj Ministria e Zhvillimit Rajonal. Pasqyrimi i financimit dhe mbështetjes së sektorit privat është paraqitur në % sipas Skemave të Granteve që implementon secila Ministri (MZHR, MINT dhe MBPZHR).




Për Ministrinë e Zhvillimit Rajonal ka rëndësi të veçantë një shpërndarje e financimit pozitivisht e balancuar që nënkupton jo vetëm shpërndarjen ndërmjet rajonave por edhe shpërndarjen brenda komunave përbërëse të rajone zhvillimore. Shpërndarja e balancuar e financimit në komunat e rajoneve nënkupton zhvillimin rajonal të balancuar si një tërësi. Kujdes i veçantë duhet kushtuar bizneseve të atyre komunave që hasin në vështirësi që në procesin e aplikimit deri projektet ideore dhe implementimi i tyre. Numri i vogël i aplikimeve të bizneseve nga komunat e ndryshme (komunat e vogla) i cili rezulton edhe me numër të vogël të projekteve të financuara është një sinjal për Ministrinë në përgjithësi që të punohet sa më shumë me bizneset që të ngrisin kapacitetet e tyre për avancimin e potencialit për aplikim dhe realizim të projekteve.


Mëposhtë mund të shohim që Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për v.2022 kanë realizuar një financim dhe shpërndarje kënaqshëm të balancuar me një diferencë prej min/max prej 11%-12% të financimit nga rajoni në rajon, ndërsa nga grafikoni i shpërndarjes së financimit nga MINT kjo diferencë rezulton më e lartë prej një min/max prej 36% të diferencave mes rajoneve. Nëse i referohemi tabelave të mësipërme të Ministrive të Linjës, MBPZHR ka një numër të vogël të bizneseve që nuk kanë përfituar nga thirja Programi për Zhvillim Rural gjithsej (6) komuna të cilat nuk kanë përfituar, dhe vlen të theksohet që ka rajone ku komunat kanë përfituar si tërësi në kuadër të Skemës PZHR. Situatë e njëjtë qëndron edhe me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal në lidhje me Thirrjen e v.2022 nga Skema e Granteve PZHRB ku rezultojnë vetëm gjashtë (6) komuna të cilat nuk kanë qenë përfituese të Skemës. MINT në dallim prej dy ministrive të lartëcekura ka një disbalancë të theksuar të financimit të bizneseve nëpër komuna të rajoneve.

Grafikoni 36. Paraqitja grafike e shpërndarjes së balancuar sipas pesë (5) rajoneve zhvillimore të ML


- 17,425,438.89€



- 3,030,934.09 €



- 398,045.92€



## XII.Përfundime dhe rekomandime

Ministria e Zhvillimit Rajonal bazuar në mandatin ligjor që ka çdo vit zhvillon, implementon dhe menaxhon programe për zhvillim rajonal të balancuar, programe këto që rrisin zhvillimin socio – ekonomik të balancuar në Rajonet Zhvillimore të Kosovës. Këto programe kanë impakt të drejtpërdrejt në zhvillimin e bizneseve mikro dhe të vogla, zgjerimin e kapaciteteve të tyre prodhuese apo shërbyese, gjenerimin e vendeve të reja të punës si dhe zvogëlimin e importit dhe nxitjen e eksportit.

MZHR përmes këtij programi (PZHRB) në koordinim me partnerët ndërkombëtar ka arritur që ndër vite të ndihmojë bizneset të zgjerojnë kapacitetet e tyre prodhuese dhe shërbyese duke arritur një qëndrueshmëri afatgjate të funksionimit të bizneseve, poashtu ka ndikuar në rritjen e qarkullimit të bizneseve, zvogëlimin e importit si dhe nxitjen e eksportit. Poashtu janë realizuar trajnime për ngritjen e kapaciteteve të qëndrueshmërisë së bizneseve ekzistuese, në veçanti është punuar me kategorinë Start-Up në funksion të përkrahjes së tyre si biznese fillestare. MZHR si çdo vit edhe këtë vit ka mbajtur sesione informuese për aplikantët potencial/bizneset sa i përket procedurave të aplikimit. Këto sesione organizohen vazhdimisht në koordinim me AZHR-të në Rajonet Zhvillimore me të cilat operon MZHR. Realizimi i sesioneve informuese për secilin rajon bëhet me qëllim për sqarimin e programeve dhe procedurave të aplikimit, ofrimit të përgjigjeve përmes web-faqes në pyetjet e parashtruara nga aplikantët gjatë procesit të aplikimit, si dhe publikimit në web faqe të udhëzuesve ku kanë qenë të specifikuar në detaje të gjitha kushtet dhe kriteret e përkrahjes së bizneseve dhe ndërmarrësve të rinjë nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar “PZHRB-2022. Kjo ka ndikuar shumë në krijimin e besueshmërisë tek programi për qytetarët dhe ka pasur një rol edhe më të madh në proceset e llogaridhënjes dhe transparences mes institucionit dhe qytetarit. Në këtë kontekst MZHR ka rritur përkushtimin rreth krijimit të mundësive të reja bashkë me donatorë vendor dhe ndërkombëtar për ngritjen e kapaciteteve për aplikim dhe implementim të projekteve në bashkëpunim me partnerët: BERZH, UNICEF, CARITAS-in Zvicerian, projektet e financuara nga USAID, por duke mos u kufizuar vetëm tek këta donatorë. Kjo thirrje mund të konsiderohet të jetë në partneritet paralel për programet me donatorë.

Ministria e Zhvillimit Rajonal përmes kësaj skeme mbetet e përkushtuar të mbështesë edhe më fuqishëm projektet e qëndrueshme të udhëhequra nga gratë, të fuqizoj gratë në të bërit biznes si dhe të rrisë kapacitetet e tyre profesionale dhe menaxheriale për një qëndrueshmëri afatgjate

të biznesit. Vlen të theksohet që në v.2022 kemi një rritje shumë të madhe të projekteve përfituese nga gratë për dallim nga vitet e mëhershme në numër prej **134** projektesh.

Gjithashtu kjo skemë inkurajon aplikime me projekte inovative nga të rinjtë si dhe komunitetet jo shumicë. Duhet ti kushtohet më tepër rëndësi stimulimit të aplikimit të përfituesve nga komunitetet jo shumicë ku sfida e mos aplikimit nga komunitetet pakicë është një sfidë në të cilën duhet të punohet dhe të stimulohen sa më shumë komunitete nga secili rajon zhvillimor për të përfituar nga skemat apo programet që implementon MZHR.

Ministria e Zhvillimit Rajonal në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar ka mbështetur dhe vazhdon të mbështesë edhe përmes kësaj thirrje prodhimin dhe shërbimet. Nga programet që ka implementuar MZHR, shërbimet kanë pasur rritje më të madhe në krahasim me sektorin e prodhimit. Konsideruar paraqitjen e grafikoneve të lartëcekur shohim se **130** projekte apo **39%** e përfituesve janë mbështetur në sektorin e prodhimit dhe **202** projekte apo **61%** e përfituesve janë mbështetur në sektorin e shërbimeve. Këtë diferencë mes sektorëve e ka ndikuar nr. më i madh i aplikuesve më të rinj në kuadër të Lot1 Start Up që ka mbështetur PZHRB ku është vërejtur që kjo moshë është më shumë e fokusuar në sektorin e shërbimeve duke i vënë theks fushës së IT-së dhe shërbimet inxhinierike. Bazuar në Lotet që janë mbështetur, vlerat e qarkullimit sipas tyre, shohim se numri më i madh i bizneseve është mbështetur në veprimtarinë e shërbimeve që korrespondojnë me bizneset e reja “Start Up”. Në këtë lot është pranuar edhe numri më i lartë i aplikimeve në gjithë rajonet zhvillimore me të cilat operon Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Implementimi i këtyre programeve në shumë prej **(3,030,934.09) euro** përmes përkrahjes së bizneseve të reja me potencial rritje dhe mbështetjes së bizneseve egzistuese me numër prej **871** të punësuar të rinjë ka ndikuar kështu në uljen e papunësisë. Nga ky numër i përgjithëshëm, **409 apo 47%** janë të punësuarat gra dhe **462 apo 53% burra**. Përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve dhe stimulimin e eksportit të produkteve vendore, stimulimin e ideve inovative ka ndikuar pozitivisht edhe në mirëqenjen e përgjithshme të qytetarëve gjatë periudhës sfiduese pandemike me të cilën janë ballafaquar gjitha bizneset. Është inkurajues fakti se nga **332** projekte në total, **134** projekte udhëhiqen nga gratë dhe **198** projekte udhëhiqen nga burrat. Rajoni në të cilin më së shumti kanë përfituar gratë është Rajoni Zhvillimor Qendër (Prishtina me komunat përreth).

Me funksionalizimin e sistemit E-kosova dhe aplikimin online Ministria e Zhvillimit Rajonal ka arritur avancim në: ekonomizimin dhe efektshmërinë në kohës gjatë procesit të aplikimit, avancimim e nivelit të aplikimit, ka rritur transparencën dhe llogaridhënjen në raport me aplikantët dhe përshpejtimin e procesit të vlerësimit.

Gjithashtu duhet të theksohet që kemi një kërkesë të madhe me një numër të madh të aplikimeve në *Lot 1(Start Up)* të mbështetur në kuadër të PZHRB-së ku është pranuar edhe numri më i madh i aplikimeve prej 835 aplikimesh nga pesë rajonet zhvillimore, me një diferencë të madhe në kërkesë në krahasim me Lotet tjera. Përkushtim edhe më i madh kërkohet nga MZHR për të stimuluar këtë kategori duke mundësuar kështu përkrahjen ideve të reja tek bizneset fillestare e që përfaqësohen kryesisht nga moshat e reja. Gjithashtu MZHR rekomandohet të avancojë qasjen ndaj këtij Loti (Start Up), duke mundësuar një thirrje të pakufizuar në afate të aplikimit dhe një mbështetje të MZHR-së nga ideja fillestare , inkubimi deri te financimi dhe realizimi i idesë/projektit. MZHR duhet të ngrisë kapacitete e sajë humane duke krijuar struktura profesionale për të mbështet këtë Lot. Gjithashtu referuar Udhëzuesit për Aplikant ( PZHRB 2022), MZHR duhet të mbështesë edhe kategorinë e Start Up-ve regjistrimi i të cilëve ka qenë para periudhës së financimit duke vendosur kriteret e financimit të kësaj kategorie të Start Up, në mënyrë që të i'u ipet mundësia të gjitha bizneseve fillestare të cilat janë regjistruar edhe në një periudhë më të hershme të aplikojnë në Skemën e Granteve PZHRB.

Poashtu referuar praktikave të mira të Ministrive të Linjës dhe akterëve relevant rekomandojmë që për gjitha bizneset që janë deklarues të TVSH-së, TVSH-ja të jetë shpenzim i pakualifikueshëm. Me qëllim të funksionalizimit të bizneseve fillestare poashtu edhe bizneseve aktive konsiderojmë që është e nevojshme të afatizohet në periudhë funksionalizimi i pajisjes/makinerisë të blerë nga Skema dhe ky afatizimit duhet të specifikohet brenda kontartës së nënshkruar nga të dyja palët.

## Burimet e informacionit:

- Raporti i Komsionit të implementimit nga Thirrja Publike (PZHRB) 2022, protokoluar me datë: 20.04.2023 dhe Nr.protokoli:336;
- Bazuar në Raportin Financiar Vjetor të protokolluar me datë: 31.01.2023 dhe nr. Protokoli: 42;
- Udhëzimi Administrativ (MZHR) nr: 01/2018 i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ 02/2018 dhe 01/2022 për kushtet dhe kriteret e përkrahjes së bizneseve dhe ndërmarrësve të rinjë nga Programi për Zhvillim Rajonal të balancuar “PZHRB” ;
- <https://mzhr.rks-gov.net/publikimet/>
- DocuShare
- Raporti nga MINT;
- Raporti nga MBPZHR.